



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit – Ministarstvo Kulturu, Omladine i Sporta -
Ministry of Cultur, Youth and Sports*

STRATEGJIA SHITETËRORE PËR RININË 2024-2032

Përmbajtja

Shkurtesat	3
I. Hyrja	4
II. Metodologjia	6
III. Sfidat Aktuale të të Rinjve në Kosovë	9
IV. Vizioni, Objektivi Strategjik, dhe Masat Prioritare	16
Vizioni	17
Objektivat.....	17
V. Mekanizmat e Zbatimit, Monitorimit dhe Vlerësimit	20
Mekanizmat e Zbatimit dhe Koordinimit.....	20
Monitorimi dhe Vlerësimi	20
Shtojca 1: Plani i Veprimit (2024-2026)	22
Shtojca 2: Pasaporta e Treguesve	41
Shtojca 3: Bashkëpunimi me Komunitetet	48

Shkurtesat

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
FES	Fondacioni Friedrich Ebert
KShR	Komisioni Shtetëror për Rini
KVRL	Këshilli i Veprimit Rinor Lokal
LGBTIQ+	Persona lezbikë, homoseksualë, biseksualë, transgjjinorë, queer dhe interseks (LGBTIQ+)
M&V	Monitorimi dhe Vlerësimi
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
NEET	Të rinj që nuk janë të punësuar ose që nuk ndjekin ndonjë shkollim apo trajnim
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OJQ	Organizatat Jo-Qeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë
RCC	Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal
SShR	Strategjia Shtetërore për Rininë
PISA	Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve
QRK	Qeveria e Republikës së Kosovës
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi Ndërkombëtar i Kombeve Bashkuara për Emergjencat e Fëmijëve
UNKT	Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

I. Hyrja

Me një moshë mesatare të popullsisë prej vetëm 26 vjeç (prill 2011)¹, Kosova është shteti më i ri në Ballkan Perëndimor dhe në Evropë.² Mbi 477,000 të rinjë në Kosovë janë të moshës 15-29 vjeçare, duke përbërë kështu rreth 30% të popullsisë në vend. Ky avantazh demografik padyshim që paraqet një mundësi unike për zhvillimin ekonomik e shoqëror të vendit. Investimet në rininë Kosovare nuk janë vetëm një përgjegjësi politike, ato janë domosdoshmëri strategjike për zhvillimin e tërë shtetit. Fuqizimi i të rinjëve, përpos rëndësisë që ka në rritjen e mirëqënies dhe suksesit të tyre individual, gjithashtu mban në dorë çelësin për të shtyrë përpara progresin e vendit dhe për ndërtimin e një shoqërie gjithpërfshirëse e të qëndrueshme. Andaj, avancimet e sotshme të potencialit të të rinjëve padyshim që janë kyçe për formimin e një të ardhme më të begatshme për shoqërinë Kosovare në përgjithësi.

Ndonëse gjatë viteve të fundit janë bërë përmirësime të rëndësishme drejt zhvillimit të të rinjëve në Kosovë, nevojitet adresim më efektiv i sfidave kryesore me të cilat ata aktualisht përballen (të përmbledhura më hollësisht në kapitullin e dytë të këtij dokumenti). Trajtimi efektiv i këtyre sfidave, që i përfshin të gjithë të rinjtë, pa dallim, është imperativ për rritjen e mundësive që ata të realizojnë potencialin e tyre të plotë dhe, si rrjedhojë, të kontribuojnë drejt zhvillimit të mbarë vendit. Shkalla e papunësisë së të rinjëve 15-24 vjeç në Kosovë ka pësuar rënie të theksuar gjatë dhjetë viteve të fundit (nga 55% në vitin 2012, në 38% në vitin 2021).³ Megjithatë, ka ende punë për t'u bërë drejt fuqizimit dhe integritimit ekonomik të të rinjëve, e veçanërisht të vajzave dhe grave, pakicave etnike, të rinjëve me aftësi të kufizuara, dhe të rinjëve tjerë të marginalizuar, të cilët përjetojnë shkallë më të lartë të përjashtimit socio-ekonomik. Progres i rëndësishëm është arritur edhe në rritjen e pjesëmarrjes në arsim në të gjitha nivelet. Megjithatë, mesatarja e shkollimit të nxënësve 15 vjeçarë në Kosovë është 5.3 vite prapa mesatares së OECD-së në lexim, matematikë, dhe shkencë.⁴ Përmirësimi i cilësisë së arsimit (formal dhe joformal) është më se i nevojshëm marrë parasysh rolin e tij si një forcë kyçe për fuqizimin e të rinjëve me shkathtësi jetësore, thelbësore për zhvillimin e tyre personal dhe profesional, si dhe përgatitjes më të mirë të tyre për tregun aktual dhe të ardhshëm të punës⁵. Më tej, edhe pse gjendja e përgjithshme e shëndetit dhe sigurisë së të rinjëve në Kosovë është e mirë, akoma ka potencial për përmirësim të shërbimeve të ofruara në këto fusha, veçanërisht të atyre që synojnë parandalimin dhe trajtimin e çështjeve të shëndetit mendor, shëndetit seksual dhe riprodhues, sigurisë (përfshirë ngacmimet, dhunën, etj.), si dhe përdorimit apo abuzimit me substanca të ndryshme narkotike. Kosova gjithashtu ka shënuar progres në përmirësimin e politikave rinore. Por, marrë parasysh potencialin e lartë të rinisë në ndryshimin pozitiv të rrethanave socio-politike në Kosovë⁶, fuqizimi i

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK): Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë, 2011

² Sipas regjistrimit të popullsisë së vitit 2011, të rinjtë dhe të rejat nën moshën 29 vjeç përbëjnë rreth 55.4% të popullsisë së Kosovës. Prej tyre 28% janë të rinj nën 15 vjeç, 19.3% janë të moshës 15-24 vjeç, ndërsa 8.1% të moshës 25-29, që së bashku përbëjnë rreth 42% të popullsisë në moshë pune.

³ Agjencia e Statistikave të Kosovës: Anketat e Fuqisë Punëtore 2021

⁴ OECD: Rezultatet e PISA 2018. [Performanca e nxënësve në lexim, matematikë, dhe shkencë](#)

⁵ Fakti që shumica (54%) e të rinjëve të cilët janë aktivë në tregun e punës në Kosovë punojnë në punë që nuk përputhen me profesionin e tyre, konfirmon mospërputhjen ndërmjet arsimit dhe nevojave të tregut të punës.

⁶ Për dallim nga shumë prej shteteve tjera të zhvilluara, të paktën që nga viti 2009, pjesëmarrja e votuesve të rinjë në zgjedhje të ndryshme në Kosovë, veçanërisht e atyre të moshës 18-21 vjeç, ka qenë vazhdimisht më e lartë krahasuar me të gjitha grupmoshat tjera (*Burimi: Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (IFES) (2016): Përqindja e votuesve të rinj në Kosovë*)

tyre për pjesëmarrje në procese vendimmarrëse e politikëbërëse, përfaqësim, dhe qytetari aktive është i domosdoshëm për krijimin e një shoqërie përparimtare e kohezive, të gatshme për përballimin e ndryshimeve globale, përfshirë ato klimatike dhe teknologjike. Përpilimi dhe zbatimi i politikave dhe intervenimeve jo vetëm për të rinjtë, por së bashku me ta, paraqet një faktor kyç për avancimin e efikasitetit të tyre dhe arritjen e rezultatet e dëshiruara.

Strategjia Shtetërore për Rininë 2024-2032 (në tekstin e mëtejshëm SShR) vjen si një zotim i Qeverisë së Republikës së Kosovës ndaj të rinjve Kosovarë që t'ju mundësojë atyre, pa përjashtim, realizimin e nevojave, të drejtave, aspiratave, si dhe potencialit të tyre të plotë njerëzor. Përmes masave politike dhe veprimeve të planifikuara, kjo Strategji synon tu ofrojë të rinjve Kosovarë mundësi dhe përvoja që mbështesin integrimin e tyre në shoqëri dhe përkrahin fuqizimin e tyre si agjentë të zhvillimit të një shoqërie gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Strategjia Shtetërore për Rininë 2024-2032 është dokument strategjik që përcakton vizionin, synimet afatmesme, masat prioritare të politikave, si dhe veprimet specifike për përmirësimin e mirëqenies dhe pozitës së të rinjve në shoqëri. Strategjia pasqyron qëndrimet dhe prioritetet e të rinjve Kosovarë për të tashmen dhe të ardhmen dhe paraqet një mekanizëm kyç për zhvillimin dhe koordinimin e politikave rinore në nivel shteti. SShR mbulon një periudhë nëntëvjeçare (2023-2032), dhe shoqërohet me tre plane të detajuara veprimi, duke filluar me planin e parë të veprimit që mbulon periudhën 2024-2026 për të vazhduar më pas me dy planet tjera të veprimit që mbulojnë periudhat 2027-2029 dhe 2030-2032. Me termin 'të rinj', kjo Strategji nënkupton të gjithë personat e moshës 15 deri në 29 vjeçare, që paraqet grupmoshën e cila targetohet nga kjo Strategji. Ky term parashihet edhe në draft Ligjin për Rini dhe është në përputhje edhe me përkufizimin e të rinjve të përdorur në Strategjinë Evropiane për Rininë 2019-2027.

Marrë parasysh se problemet me të cilat përballen të rinjtë Kosovarë janë komplekse dhe të ndërlikura ngushtë me njëra-tjetrën, adresimi efektiv dhe efikas i tyre kërkon një qasje ndërsektoriale kundrejt asaj sektorale, që ngërthen në vete një sinergji, koordinim, dhe bashkëveprim të ngushtë të të gjithë akterëve relevantë. Andaj, kjo Strategji, e para e llojit të saj në fushën e rinisë, është Strategji ndërministrare, e cila parasheh angazhimin, kontributin, dhe partneritetin e ngushtë mes institucioneve shtetërore qendrore e lokale, shoqërisë civile, organizatave rinore, organizatave për të rinjtë, sektorit privat, partnerëve tjerë zhvillimorë vendorë e ndërkombëtarë, si dhe vetë të rinjve. Për më tepër, kjo Strategji shërben si Strategji ombrellë, duke shtjelluar dhe përfshirë në vete të gjitha Strategjitë apo dokumentet tjera sektoriale të cilat ndërlidhen me rininë dhe synojnë adresimin e sfidave me të cilët ata ballafaqohen.

Më specifikisht, SShR mbulon këto fusha kyçe tematike që janë identifikuar dhe prioritizuar nga vetë të rinjtë: arsimin, punësimin, shëndetin, sigurinë, mbrojtjen e mjedisit, vullnetarizmin, angazhimin qytetar, kulturën dhe rekreacionin, dhe barazinë dhe gjithëpërfshirjen.

Strategjia trajton çështjet ose sfidat aktuale të të rinjve në Kosovë dhe formulon objektiva dhe politika specifike dhe veprime shoqëruese për adresimin e tyre. SShR parashikon tregues për matjen e performancës, arritjeve, dhe ndikimit të Strategjisë, të shpërndarë në çdo fushë tematike. Me këtë hap do të vlerësohen efektet reale të asaj që parashikohet në kuadër të Strategjisë dhe do të sigurohet një sistem gjithëpërfshirës monitorimi dhe vlerësimi.

Qëllimet e përcaktuara, masat e veprimit, dhe aktivitetet specifike janë bazuar në sfidat e identifikuar dhe të raportuara nga vetë të rinjtë por janë frymëzuar edhe nga politikat dhe parimet e përcaktuara në Strategjinë Evropiane për Rininë 2019-2027, si dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara. Strategjia nxjerr në pah mundësitë për një qasje ndërsektoriale, koherente, dhe sistematike për adresimin e sfidave të zhvillimit të të rinjve.

Kjo Strategji është draftuar përmes një procesi bashkëpunues ndërmjet Qeverisë dhe palëve të tjera të interesuara, përfshirë departamentet qeveritare, agjencitë shtetërore, komunitat, donatorët, organizatat joqeveritare, dhe vetë të rinjtë.

II. Metodologjia

Metodologjia e hartimit të Strategjisë është bazuar në Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit si dhe në Manualin për Zhvillimin dhe Monitorimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit. Procesi i hartimit të Strategjisë përfshiu gjithsej pesë faza (duke përfshirë atë të fundit, pra finalizimin dhe miratimin e Strategjisë), të cilat janë shtjelluar më detajisht në paragrafet vijuese.

Faza 1: Faza e përgatitjes: Faza e përgatitjes së draftimit të SShR-së ka filluar qysh në vitin 2022, fillimisht me draftimin dhe miratimin e [Koncept Dokumentit për Rininë](#) (miratuar më 16 dhjetor të vitit 2022)⁷ si dokument pararendës i Projektligjit për Rininë, zhvillimin e procesit dhe publikimit të raportit 'Dialogu Kombëtar për Rininë' në gusht të vitit 2022⁸, si dhe përpilimin e raportit të vlerësimit të Strategjisë paraprake për të Rinjtë (2019-2023), i cili u finalizua në janar 2023. Raporti i vlerësimit të Strategjisë paraprake analizoi se deri në çfarë mase ndërhyrjet e miratuara në këtë Strategji kanë qenë i) të rëndësishme apo relevante, ii) koherente (me ndërhyrjet tjera të Qeverisë), iii) të zbatuara, iv) efektive, v) efikase, vi) të qëndrueshme, dhe vii) gjithpërfshirëse. Vlerësimi, i cili mbuloi periudhën 2019-2022, u realizua përmes përdorimit të metodave cilësore dhe sasore të mbledhjes së të dhënave, si i) hulumtimit të dokumenteve (si p.sh. raporteve vjetore të MKRS-së), ii) intervistave të thelluara, dhe iii) zhvillimit të anketës me përfituesit e mbështetjes financiare për themelimin të bizneseve fillestare ose start-up. Disa prej rekomandimeve kryesore të këtij vlerësimi të cilat kanë formësuar strukturën dhe përmbajtjen e SShR-së, mund të përmbledhen si në vijim:

- a. Hartimi i një strategjie ndërministrorë kundrejt asaj sektorale, e cila përfshin edhe komunitat dhe partnerët zhvillimorë;
- b. Koordinim dhe ndarje më e mirë e përgjegjësi ndërmjet institucioneve;
- c. Dialog më i gjerë në identifikimin e sfidave më relevante dhe aktuale të të rinjve të cilat nuk janë trajtuar në nivelin e dëshiruar, si shëndeti mendor, siguria, mbrojtja e mjedisit, etj.;
- d. Përfshirje më e madhe e të rinjve të marginalizuar;

⁷ Ky koncept dokument fokusohet në përmirësimin e politikave për të rinjtë në Kosovë me qëllim fuqizimin e tyre, rritjen e pjesëmarrjes së tyre në të gjitha sferat e jetës, dhe rritjen e punësueshmërisë së tyre duke u ofruar atyre aftësi dhe mundësi përkatëse.

⁸ Në vitin 2021, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për herë të parë nisi Dialogun Kombëtar për Rini, proces ky i cili parasheh organizimin e takimeve, intervistave, fokus grupeve dhe anketave për të mbledhur të dhëna sasore dhe cilësore mbi sektorin rinor. Raporti me gjetjet e këtij Dialogu u publikua në 2022, duke përmbledhur perceptimet e pjesëmarrësve të ndryshëm (sit ë rinjtë, zyrtarët komunalë për rini, udhëheqësit e organizatave jo-qeveritare, partnerët zhvillimorë, etj.) për situatën dhe sfidat aktuale në sektorin rinor.

- e. Krijimi dhe zbatimi i një kornize efektive për monitorimin dhe vlerësimin e Strategjisë së ardhshme; dhe
- f. Investim më i madh në mbledhjen e të dhënave për monitorimin e zbatimit të politikave dhe arritjes së objektivave.

Gjatë kësaj faze është bërë edhe shqyrtimi dhe analizimi i dokumenteve të ndryshme relevante vendore e ndërkombëtare që pasqyrojnë gjendjen aktuale të rinisë në Kosovë. Më tej, përpos këshillimit të koncept dokumentit për rininë, dialogut për rininë, dhe shqyrtimit të hollësishtëm të raportit të vlerësimit të Strategjisë paraprake dhe planit shoqëruar të veprimit, janë shqyrtuar edhe Strategjitë sektoriale ekzistuese dhe projektet e zbatuara nga institucionet publike dhe organizatat vendore e ndërkombëtare. Gjithashtu gjatë kësaj faze është bërë rishikimi i përvojës së shteteve rajonale dhe të Bashkimit Evropian (BE-së).⁹ Më tutje, janë ftuar të gjitha ministritë dhe komunat e Kosovës (përmes Drejtorive për Kulturë, Rini dhe Sport) të ndajnë informata mbi projektet dhe kontributet e realizuara ose të planifikuara për rininë.

Faza 2: Faza e identifikimit, konsultimit, dhe zgjedhjes së sfidave që duhet të trajtohen në Strategji (Maj & Qershor 2023): Gjatë fazës së dytë fillimisht janë rishikuar treguesit kyç që pasqyrojnë situatën e të rinjve në Kosovë, përfshirë qasjen e të rinjve në tregun e punës, cilësinë e arsimit, qasjen e të rinjve në trajnime dhe punë praktike, sjelljet e shëndetshme (përfshirë shëndetin mendor, pirjen e duhanit, konsumimin e alkoolit, përdorimin dhe varësinë nga droga, etj.), angazhimin qytetar, sigurinë, pjesëmarrjen e tyre në aktivitete kulturore dhe sportive, angazhimin e tyre në aktivitete vullnetare, etj., si dhe të sfidave të ndryshme me të cilat përballen institucionet kryesore, përfshirë sipas gjinisë, përkatësisë etnike dhe komunës aty ku ka pasur të dhëna të disponueshme. Sfidat e identifikuara varësisht nga situata personale e të rinjve janë elaboruar në kapitullin III: Sfidat Aktuale të të Rinjve në Kosovë.

Përmes analizës së treguesve kyç, që mbuluan nëntë fusha tematike kryesore¹⁰, u identifikuan 37 sfida specifike kryesore të të rinjve në Kosovë. Më pas, kjo listë u shpërnda dha u diskutua online dhe drejtpërdrejtë me akterë të gjerë si pjesë e dialogut me të rinjtë. Fillimisht, u zhvillua dhe lansua një pyetësor online, i cili kishte për qëllim mbledhjen e mendimeve të të rinjve lidhur me sfidat më të mëdha me të cilat ata po ballafaqohen dhe rrjedhimisht edhe identifikimin e sfidave më të rëndësishme që duhet të trajtohen në Strategji. Pas shqyrtimit të rezultateve të pyetësorit, u organizuan edhe konsultime fizike dhe online me gjithsej 90 përfaqësues të grupeve të ndryshme të të rinjve, gjegjësisht me i) përfaqësues të organizatave joqeveritare (OJQ) të ndryshme që fokus kryesor të punës së tyre e kanë rininë, ii) përfaqësues të OJQ-ve të cilat përfaqësojnë apo punojnë me të rinj serb; iii) përfaqësues të OJQ-ve të cilat përfaqësojnë apo punojnë me të rinj me aftësi të kufizuara; iv) përfaqësues të OJQ-ve të cilat përfaqësojnë apo punojnë me të rinj romë, ashkalinjë,

⁹ Kjo fazë ka shqyrtuar: Strategjia për Rininë 2019- 2023; Strategjinë e BE-së për Rininë 2019-2027; Strategjinë e Arsimit 2022-2026; Strategjinë për Migrim 2021-2025; Draft Strategjinë për Drejtësi Tranzicionale; Draft Planin e Veprimit për Zbatimin e programit 'Garancia Rinore'; Plani Kombëtar për Zhvillim 2030; Strategjinë Nacionale për Siguri në Bashkësi (2018-2023); Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026; Planin e Veprimit 'Shëndeti Mendor pas Pandemisë COVID-19'; Strategjinë për Ndryshimet Klimatike 2019- 2028; Planin e Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2021-2023; Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024; Strategjinë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026; Strategjinë e Rinisë të Shqipërisë dhe Planin e Veprimit 2022- 2029; Strategjinë e Rinisë së Maqedonisë së Veriut 2023-2027; Plani Zhvillimor të Sektorit Rinor të Estonisë 2021-2035.

¹⁰ 1. Arsimi; 2. Punësimi; 3. Shëndeti; 4. Siguria; 5. Mbrojtja e mjedisit; 6. Vullnetarizmi; 7. Angazhimi Qytetar; 8. Kultura dhe Rekreacioni; dhe 9. Barazia dhe Gjithpërfshirja.

dhe egjiptian; dhe v) të rinj pjesëmarrës në punëtorinë vjetore të Asamblesë Rinore të OKB-së (UN Youth Assembly). Këto konsultime u organizuan me qëllim të diskutimit të gjetjeve të pyetësorit si dhe të mbledhjes së mendimeve të të rinjve lidhur me shkaqet e sfidave kryesore të identifikuara dhe për mënyrat më të mira për trajtimin e tyre.

Më pas, lista e sfidave kryesore me të cilat ballafaqohen të rinjtë, rezultati i procesit të konsultimeve të zhvilluara, si dhe gjetjet tjera kryesore nga faza e përgatitjes u janë prezantuar Komisionit Shtetëror për Rini (KShR) në takimin e mbajtur me 28 Qershor 2023. Gjithashtu, gjatë këtij takimi, u definuan dhe diskutuan sfidat kryesore të të rinjve të cilat do të trajtohen në Strategji si dhe u definua dhe dakordua qasja ombrellë e Strategjisë.

Faza 3: Formulimi i objektivave të Strategjisë (Korrik 2023): Gjatë fazës së tretë është organizuar një punëtori dy-ditore me grupin punues, mbajtur më 12 dhe 13 Korrik 2023, gjatë së cilës është definuar korniza e Strategjisë. Më konkretisht, është formuluar vizioni dhe objektivat (strategjike dhe specifike) të SShR-së (të shtjelluara më detajisht në kapitullin e katërt të këtij dokumenti), si dhe opsionet kryesore të politikave apo masave për trajtimin e sfidave rinore të përzgjedhura, të frymëzuara nga kufizimet kryesore të institucioneve relevante por edhe nga kuadri i politikave të BE-së. Politikat e zgjedhura janë teknikisht të arsyeshme dhe të përshtatura me kontekstin lokal; ato krijojnë sinergji dhe/ose të plotësojnë Strategjitë tjera përkatëse dhe projekte të tjera madhore të menaxhuara nga institucione dhe organizata vendore dhe ndërkombëtare.

Faza 4: Hartimi i draftit të parë të Strategjisë dhe Planit të parë të Veprimit (2024-2026) (Gusht & Shtator 2023): Në kuadër të fazës së katërt të procesit të hartimit të Strategjisë, është hartuar drafti i parë i Strategjisë, i cili përfshin kontributet nga të gjitha ministritë relevante, komunat, dhe organizatat ndërkombëtare. Së bashku me hartimin e draftit Strategjisë, është hartuar edhe Planit i Veprimit për periudhën 2024-2026, i cili përfshin përcaktimin e veprimeve kyçe bazuar në masat e politikave, burimet kryesore, afatin kohor, përgjegjësitë e caktuara, etj. Plani i veprimit gjithashtu përfshin edhe masat politike dhe aktivitetet specifike të parapara nga Strategji tjera sektorale të cilat janë në fuqi brenda periudhës 2024-2026. Gjithashtu, gjatë kësaj faze është hartuar edhe draft korniza e Monitorimit dhe Vlerësimit (M&V) për SShR-në, e cila përfshin deklaratat e rezultateve të Strategjisë me treguesit e performancës, mjetet e verifikimit, metodat e mbledhjes së të dhënave, situatën bazë, si dhe caqet përkatëse për çdo tregues.

Faza 5: Konsultimi dhe validimi i Strategjisë: Gjatë kësaj faze, janë organizuar konsultime të ndryshme online dhe të drejtpërdrejta, ku palët e interesuara kanë pasur mundësi të ofrojnë mendimet dhe komentet e tyre lidhur me draftin e Strategjisë, Planit të Veprimit (2024-2026), dhe kornizës së Monitorimit dhe Vlerësimit. Drafti i Strategjisë dhe Planit të Veprimit gjithashtu janë publikuar në Platformën e Qeverisë së Republikës së Kosovës për Konsultime Publike dhe kanë qenë të hapura për konsultime paraprake (nga 13 tetor 2023 deri më 2 nëntor 2023) dhe konsultim publik nga 6 nëntor 2023 deri më 30 nëntor 2023. Komentet, sugjerimet, dhe vërejtjet e pranuar gjatë këtij procesi janë shqyrtuar me kujdes dhe janë inkorporuar në verzionin përfundimtar të Strategjisë. Mbi 485 të rinj dhe përfaqësues të OJQ-ve të ndryshme që mbështesin zhvillimin e të rinjve morën pjesë në zhvillimin e kësaj Strategjie.

III. Sfidat Aktuale të të Rinjve në Kosovë

Ndonëse gjatë viteve të fundit janë regjistruar përmirësime të shumta në fushat me ndikim të drejtpërdrejt në zhvillimin e rinisë, të rinjtë në Kosovë vazhdojnë të përballen me sfida të ndryshme të cilat u vështirësojnë atyre realizimin e të drejtave, nevojave, dhe potencialit të tyre të plotë. Kosova ka shënuar progres të majmë në rritjen e pjesëmarrjes në arsim në të gjitha nivelet. Megjithatë, nevojiten investime në rritjen e **qasjes në arsim cilësor** në mënyrë që të rinjtë të mund të përgatiten më mirë për tregun aktual dhe të ardhshëm të punës. Sipas rezultateve të Programit për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA) të vitit 2018, 77% e nxënësve 15-vjeçarë në Kosovë nuk kanë arritur nivelin minimal të aftësive lexim, matematikë dhe shkencë, krahasuar me më pak se 50% në vendet fqinje dhe 22% me mesataren e shteteve të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD).¹¹ Këto rezultate tregojnë se nxënësit Kosovarë janë pesë vite shkollimi prapa mesatares së OECD-së në lexim, dhe pak më shumë se katër vjet prapa në matematikë.¹² Pakënaqësia me cilësinë e arsimit duket edhe nga perceptimet e vetë të rinjve.¹³ Të rinjtë romë, ashkalinjë dhe egjiptas, të rinjtë me aftësi të kufizuara, dhe të rinjtë që rriten dhe jetojnë në varfëri, përjetojnë shkallë më të ulët të pjesëmarrjes dhe përfundimit të shkollimit në të gjitha nivelet e arsimit. Për shembull, ndërsa ndjekja e arsimit fillor për fëmijët dhe të rinjtë e komuniteteve rom, ashkali, dhe egjiptian është 84% (krahasuar me 100% për popullatën e përgjithshme), frekuentimi bie në vetëm 31% për arsimin e mesëm të lartë (krahasuar me 87% për popullatën e përgjithshme).¹⁴ Për më tepër, vlerësohet se rreth 88% e fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara në Kosovë nuk vijnë fare mësimin.¹⁵

Shkalla e **braktisjes së shkollës** është zvogëluar dukshëm në vitet e fundit. Megjithatë, ajo mbetet e lartë për të rinjtë nga komunitetet rom, ashkali, dhe egjiptian: 13.2% nuk e ndjekin arsimin fillor (në krahasim më 2% të popullatës së përgjithshme), 20.7% nuk e ndjekin arsimin e mesëm të ulët (2.7% për popullatën e përgjithshme), dhe rreth 58% nuk e ndjekin arsimin e mesëm të lartë (9% për popullatën e përgjithshme).¹⁶

Një numër i madh i të rinjve në Kosovë gjithashtu përballen edhe me sfida në **tregun e punës**, kryesisht si rrjedhojë e mospërputhjes së arsimit (përfshirë arsimin profesional) me nevojat e tregut të punës, si dhe për shkak të mungesës së mundësive (si p.sh. trajnime, punë praktike, etj.) që lehtësojnë tranzicionin e të rinjve nga shkolla në punë. Ndonëse shkalla e papunësisë së të rinjve 15-24 vjeç në Kosovë ka pësuar rënie të theksuar gjatë dhjetë viteve të fundit (nga 55% në vitin 2012, në 38% në vitin 2021)¹⁷, ajo ende mbetet e lartë në krahasim me mesataren e BE-së (13%)¹⁸, duke regjistruar kështu shkallën më të lartë të papunësisë të kësaj grupmoshe në Evropë. Kosova gjithashtu ka shkallën më të ulët të pjesëmarrjes në fuqinë punëtore të të rinjve në Ballkanin Perëndimor (21%), krahasuar me 24% të mesatares në rajon dhe 37.8% të mesatares së BE-së.¹⁹ Përveç kësaj, të rinjtë Kosovarë

¹¹ OECD: Rezultatet e PISA 2018. [Performanca e nxënësve në lexim, matematikë, dhe shkencë](#)

¹² Në Kosovë, performanca mesatare e 15-vjeçarëve në lexim është 353 pikë, krahasuar me 481 pikë e të rinjve në BE, në matematikë 366 pikë krahasuar me 489 në BE, dhe 365 pikë në shkencë krahasuar me 484 në BE.

¹³ Vetëm 23 % e të rinjve në Kosovë janë të kënaqur me cilësinë e arsimit, krahasuar me 30% të shteteve të Ballkanit Perëndimor (*Friedrich Ebert Stiftung: Studimi për Rininë, Kosovë*)

¹⁴ ASK & UNICEF (2020): Anketa e Treguesve të Shumëfishtë (MICS)

¹⁵ UNMIK Kosovë (2019): [38,000 fëmijë me aftësi të kufizuara nuk e frekuentojnë shkollën](#)

¹⁶ ASK & UNICEF (2020): Anketa e Treguesve të Shumëfishtë (MICS)

¹⁷ ASK (2022): Anketa e Fuqisë Punëtore 2021

¹⁸ Eurostat 2021

¹⁹ Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (2021): [Studim mbi Punësimin e të rinjve në Ballkanin Perëndimor](#)

kanë pothuajse dy herë më shumë gjasa për të qenë të papunë në krahasim me të rriturit. Sipas anketës së organizuar nga UNKT (Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë) me të rinjtë, 77% e të rinjve të anketuar të cilët ishin të papunë deklaruan se nuk kanë pasur asnjë përvojë pune²⁰. Për më tepër, një e treta (apo 32%) e të rinjve të moshës 15-24 në Kosovë dhe rreth 50% e të rinjve të moshës 25-29 vjeçare bëjnë pjesë në kategorinë e personave që nuk janë të punësuar dhe as të përfshirë në arsim/trajnim (NEET), krahasuar me 23% e të rinjve në Ballkanin Perëndimor²¹ dhe vetëm 11.7% e të rinjve në BE^{22, 23}. Nga ata që janë të punësuar, pjesa e madhe e tyre (54%) punojnë në punë që nuk përputhen me profesionin e tyre (mospërputhje horizontale e aftësive), ndërsa rreth 44 % e vendeve të punës aktuale të të rinjve kërkojnë një nivel më të ulët të arsimit formal në krahasim me nivelin ekzistues të të rinjve të punësuar në ato vende pune (mospërputhje vertikale)²⁴. Vlerësohet se 8 nga 10 të rinj të punësuar në Kosovë kanë kontratë të përkohshme pune (krahasuar me vetëm 9% të të rinjve në BE) dhe gati gjysma (48%) janë të punësuar në sektorin joformal.²⁵

Mungesa e qasjes në **shërbimet financiare** gjithashtu vështirëson mundësitë e të rinjve për sipërmarrje dhe vetëpunësim. Në vitin 2021, 44% të të rinjve (15-24 vjeç) në Kosovë kanë pasur llogari bankare (rreth 20% nën mesataren botërore prej 65.5%) dhe vetëm 11.4% kanë marrë kredi nga një institucion financiar krahasuar me 17.3 për qind të popullsisë së përgjithshme.²⁶ Rrjedhimisht, numri i sipërmarrësve të rinj të vetëpunësuar, veçanërisht i vajzave dhe grave, mbetet i ulët.

Të rinjtë në Kosovë kanë potencial të lartë në ndryshimin pozitiv të rrethanave socio-politike në Kosovë. Për dallim nga shumë prej shteteve tjera të zhvilluara, të paktën që nga viti 2009, pjesëmarrja e votuesve të rinj në zgjedhje të ndryshme në Kosovë, veçanërisht e atyre të moshës 18-21 vjeç, ka qenë vazhdimisht më e lartë krahasuar me të gjitha grupmoshat tjera.²⁷ Megjithatë, mosintegrimi ekonomik në shumë raste ndikon paralelisht edhe në **mosintegrimin social dhe demokratik** të tyre. Kjo reflektohet edhe në normen përgjithësisht të ulët të **pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje dhe politikëbërje**²⁸. Të rinjtë Kosovarë nuk kanë besim të lartë të shprehur ndaj institucioneve politike, dhe veçanërisht partive politike dhe qeverisë kombëtare. Sipas një sondazhi, 57% e të rinjve në Kosovë nuk u besojnë partive politike dhe 50% nuk u besojnë qeverisë në përgjithësi, dhe vetëm 10% janë të mendimit që interesat e tyre janë të përfaqësuara “mirë” në politikën kombëtare.²⁹ Për më tepër, shprehja e një pozicioni politik përmes aktivizimit qytetar nuk është shumë e përhapur tek të rinjtë, **pasi vetëm 13% e tyre kanë marrë pjesë në aktivitete të shoqërisë civile si vullnetarë**, krahasuar me 34% të të rinjve në BE^{30, 31}. Ndërkaq, përkundër nivelit të lartë të decentralizimit në Kosovë, qeveritë lokale hasin në vështirësi sa i përket nxitjes së pjesëmarrjes së të rinjve: shumica e këshillave lokale të veprimit rinorë nuk janë themeluar kurrë ose janë bërë joaktive, ndërsa vetëm 14 qendra rinore kanë qenë aktive në mbarë Kosovën në vitin 2022.

²⁰ UNKT (2021): Sfidat dhe këndvështrimet e të rinjve në Kosovë

²¹ Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (2021): Studim për Punnësimin e të Rinjve në Ballkanin Perëndimor

²² Eurostat 2022

²³ ASK (2022): Anketa e Fuqisë Punëtore 2021

²⁴ Friedrich Ebert Stiftung (2019): Studimi për Rininë, Kosovë

²⁵ Banka Botërore (2017). Diagnostifikimi i Punës në Kosovë

²⁶ Baza e të dhënave Globale Findex 2021

²⁷ Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore (IFES) (2016): Përqindja e votuesve të rinj në Kosovë

²⁸ 6% e të rinjve të anketuar kanë punuar në një parti politike ose grup politik dhe 7% kanë marrë pjesë në aktivitete politike përmes internetit/rrjeteve sociale (Friedrich Ebert Stiftung 2019: Studimi i të rinjve, Kosovë)

²⁹ Friedrich Ebert Stiftung (2019): Studimi për Rininë, Kosovë

³⁰ Bashkimi Evropian: [Lëvizshmëria e të rinjve vullnetarë dhe aktivitetet ndërkufitare të solidaritetit](#)

³¹ Friedrich Ebert Stiftung (2019): Studimi për Rininë, Kosovë

Emigrimi i të rinjve Kosovarë drejt shteteve të BE-së ka pësuar rënie gjatë viteve në fundit: në vitin 2015 37,085 të rinj Kosovarë të moshës 14-35 vjeç aplikuan për azil në vendet e BE-së në 2015 krahasuar me vetëm 815 në 2021. Megjithatë, dëshira dhe synimet e të rinjve për t'u zhvendosur jashtë mbeten të larta.³² Më shumë se gjysma e të rinjve aspirojnë të emigrojnë nga Kosova; nga ata, 63% për arsye ekonomike si motiv kryesor.³³ Të rinjtë meshkuj me arsim të ulët dhe të mesëm kanë prirje më të lartë për të emigruar.³⁴

Më tej, edhe pse gjendja e përgjithshme e shëndetit të të rinjve në Kosovë është e mirë, nevojitet përmirësim i shërbimeve për parandalimin dhe adresimin e disa probleme aktuale të të rinjve që lidhen me **shëndetin e tyre fizik dhe mendor**. Një përqindje e lartë (29%) e të rinjve Kosovarë (15-29 vjeç) janë duhanpirës³⁵ (krahasuar me 18% të të rinjve në BE³⁶), ndërsa 27% rregullisht konsumojnë alkool (ngajshëm me mesataren e BE-së: 30% të të rinjve në BE konsumojnë alkool në baza javore³⁷).³⁸ Ndonëse nuk ka të dhëna të sakta lidhur me përdorimin e substancave narkotike, rreth 38% e të rinjve kanë shprehur shqetësime të moderuara dhe ekstreme për përdorimin e këtyre substancave³⁹. Për më tepër, të rinjtë gjithnjë e më shumë po përballen me probleme apo çrregullime të ndryshme të shëndetit mendor, të cilat janë rritur dukshëm si pasojë e pandemisë COVID-19.⁴⁰ Mentaliteti i ngurtë social dhe një sërë tabush mbeten ende pengesë për realizimin e bisedave konstruktive dhe informimin e të rinjve mbi shëndetin mendor dhe mirëqënien emocionale. 77% të të rinjve të anketuar nga UNKT në vitin 2021 shprehën shqetësime lidhur me përballimin e stresit dhe 83% vlerësuuan shëndetin fizik dhe mendor si thelbësorë në jetën e tyre. Sa i përket **shëndetit seksual dhe riprodhues**, vetëm 40% e të rinjve Kosovarë përdorin kontraceptivë⁴¹, në krahasim me 71% të të rinjve në Evropë⁴², ndërsa 4% e të rinjve nuk janë fare të informuar mbi çështjet dhe rëndësinë e shëndetit riprodhues. Mungesa e njohurive për domosdoshmërinë dhe mundësinë e përdorimit të kontraceptivëve konsiderohet si faktori kryesor që ndër të tjerash shpie edhe tek shtatzanitë dhe lindjet në moshë të hershme, të cilat ndonëse kanë pësuar ulje në vitet e fundit⁴³, vazhdojnë të jenë të përhapura.

Të rinjtë në Kosovë poashtu po përballen edhe me dukuri që cenonjë mirëqënien dhe **sigurinë e tyre**.⁴⁴ Bullizmi (si fizik ashtu edhe ai verbal), ngacmimet (përfshirë edhe ngacmimet seksuale), dhe rastet e dhunës janë të përhapura në shkolla. Sipas anketës 'Zërat e Rinj 2022' të Save the Children Kosovë me

³² Eurostat 2015, 2021: [Aplikantët për azil sipas llojit të aplikantit, shtetësisë, moshës dhe gjinisë](#)

³³ Friedrich Ebert Stiftung (2019): Studimi për Rininë, Kosovë

³⁴ Gati gjysma (49%) e emigrantëve Kosovarë gjatë viteve 2016-2018 ishin me arsim të mesëm të përgjithshëm, 32% ishin me arsim të ulët, dhe 20% me arsim të lartë (Eurostat).

³⁵ Nënkupton pirjen e përditshme të duhanit.

³⁶ Eurostat 2019: [Pirja e duhanit sipas gjinisë, moshës, dhe nivelit arsimor](#)

³⁷ Eurostat 2019: [Frekuenca e konsumimit të alkoolit sipas gjinisë, moshës, dhe vendit të lindjes](#)

³⁸ Friedrich Ebert Stiftung (2019): Studimi për Rininë, Kosovë

³⁹ UNKT (2021): Sfidat dhe këndvështrimet e të rinjve në Kosovë

⁴⁰ Ndër to mund të cekem ankthi dhe frika e shtuar, streiti, depresioni, mungesa e vetëbesimit apo vetëvlerësimi i ulët, mendimet negative, mendimet lidhur me vetëvrasjen, etj.

⁴¹ Friedrich Ebert Stiftung (2019): Studimi i të rinjve, Kosovë

⁴² Forumi Evropian Parlamentar për të Drejtat Seksuale dhe Riprodhuese (2022): [Ndërgjegjësimi dhe përdorimi i kontraceptivëve nga të rinjtë në Evropë](#)

⁴³ 443 lindje të regjistruara nga vajza të moshës 14-19 vjeçare në vitin 2022 në krahasim me 1,001 në 2012 (ASK: Statistikat e Lindjeve).

⁴⁴ Përpos që janë më të rrezikuar të bëhen viktime të dhunës apo ndonjë krimi tjetër, të rinjtë, ndryshe nga të rriturit, hezitojnë t'i raportojnë këto raste tek institucionet përkatëse për arsye të ndryshme. Kjo mund të ndodhë për arsye të ndryshme si frika, turpi, kërcënimet e ndryshme, mungesa e informatave rreth mekanizmave të raportimit, mungesa e besimit në institucionet mbrojtëse, etj. ([Organizata Botërore e Shëndetësisë \(2015\): Parandalimi i dhunës tek të rinjtë: Një përmbledhje e dëshmimeve](#)).

të rinj të moshës 13-17 vjeçare rezulton se 35% e tyre janë ndjerë të bullizuar ose të ngacmuar gjatë vitit të kaluar.⁴⁵ Anketa të tjera tregojnë se të rinjtë ndihen më të sigurt në lagje sesa në shkollë.⁴⁶ Ndonëse të dhëna të sakta mungojnë, shumë të rinj kanë qasje në armët që familjarët e tyre i mbajnë ilegalisht në shtëpi, gjë që po ndikon edhe në përfshirje më të lartë të të rinjve në aktivitete kriminale. **Siguria kibernetike** dhe nevoja për të sensibilizuar të rinjtë për kërcënimet kibernetike është po aq e rëndësishme. Rreth 14% e djemve dhe 9% e vajzave (të moshës 13-17 vjeç) të përfshirë në anketën 'Zërat e Rinj 2022' deklaruan se rrallë ose kurrë nuk ndihen të sigurtë në internet, ndërsa vetëm 60% e djemve dhe 62% e vajzave deklaruan se janë mësuar në shkollë si ta përdorin internetin në mënyrë të sigurtë.⁴⁷ Gjatë viteve të fundit janë regjistruar edhe rritje në rastet e **dhunës dhe vrasjeve në bazë gjinore** në Kosovë⁴⁸, që prekin edhe grupmoshat e reja.⁴⁹ Në vitin 2020, rreth 16% e vajzave dhe grave të moshës 15-29 vjeç (kundrejt 13% të djemve dhe burrave) konsideruan dhunën në familje si diçka të justifikueshme.⁵⁰ Normalizimi i dhunës në familje është më i përhapur tek të rinjtë e komuniteteve rom, ashkali, dhe egjiptian.

Ndonëse qasja dhe sjelljet ndaj të rinjve të marginalizuar në Kosovë kanë shënuar përmirësime në vitet e fundit, ata vazhdojnë të ballafaqohen me **pabarazi, diskriminim, dhe stigmatizim**, fenomene këto që pengojnë realizimin dhe shfrytëzimin e plotë të potencialit njerëzor të tyre. Vajzat dhe gratë, pakicat etnike, të rinjtë me aftësi të kufizuara, dhe të rinjtë të cilët jetojnë në zona rurale, përballen me barriera shtesë në qasjen në shërbime dhe mundësi për shkak të shtresave të shumta të diskriminimit dhe normave kufizuese kulturore. **Të rejtat në Kosovë** janë të nënpërfaqësuar në çdo nivel të arsimit përveç universitetit.⁵¹ Megjithatë, edhe me arsim universitar të avancuar, ato kanë norma më të ulëta të punësimit, janë të nënpërfaqësuar në pozitat menaxheriale dhe profesionale, dhe janë të mbipërfaqësuar në sektorët që lidhen me rolin e tyre tradicional, përfshirë sektorët e arsimit, tregtisë, dhe shëndetësisë.⁵² Shkalla e papunësisë së vajzave dhe grave (15-24 vjeç) në Kosovë është 46.5%, krahasuar me 33.7% të djemve dhe burrave. Përderisa hendeuku gjinor në pjesëmarrjen e të rinjve në fuqi punëtore është i ngjashëm në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor, shkalla e pjesëmarrjes së grave të reja në tregun e punës në Kosovë është sa gjysma ose më pak se gjysma e asaj në vendet e tjera në rajon. Pjesëmarrja në fuqi punëtore e vajzave dhe grave të moshës 15-29 është gjithashtu më e ulët (22%) në krahasim me atë të meshkujve (40%).⁵³ Për më tepër, normat tradicionale shoqërore në Kosovë ua caktojnë përgjegjësitë familjare pothuajse ekskluzivisht grave, gjë që pengon zhvillimin e tyre profesional dhe përkushtimin ndaj karrierës. 32% e vajzave dhe grave në Kosovë raportojnë detyrat e kujdesit për fëmijët si arsyen kryesore të pasivitetit ekonomik, në krahasim me vetëm 1.1% të djemve dhe burrave.⁵⁴ Ngjashëm, sipas një studimi të realizuar në vitin

⁴⁵ Save the Children Kosova (2022): [Zërat e Rinj](#)

⁴⁶ Sipas anketës së UNKT-së, rreth 86% raportuan se ndiheshin shumë të sigurt ose disi të sigurt në lagjen e tyre, në krahasim me 68% që ndiheshin shumë të sigurt ose disi të sigurt në shkollë.

⁴⁷ Save the Children Kosova 2022. Ndersa 85% e të anketuarve mendojnë se Kosova duhet të bëjë më shumë për ta parandaluar bullizmin kibernetik

⁴⁸ Numri i rasteve të dhunës në familje të raportuara në polici është rritur në mënyrë të qëndrueshme, nga 1,915 në 2019-n dhe pak më shumë se 2,000 në 2020 në mbi 2,400 në 2021 ([Fondacioni Kvinna till Kvinna \(2022\): Të Drejtat e Grave në Ballkanin Perëndimor](#)).

⁴⁹ Vlen të përmenden rasti i 18-vjeçares Marigona Osmani e cila u përdhunua dhe u vra barbarisht nga dy meshkuj në Gusht të vitit 2021, si dhe rasti i përdhunimit të 11-vjeçares në Gusht të vitit 2022, e cila u përdhunua nga 5 meshkuj, tre prej të cilëve ishin të mitur ([Fondacioni Kvinna till Kvinna \(2022\): Të Drejtat e Grave në Ballkanin Perëndimor](#)).

⁵⁰ ASK & UNICEF (2020): Anketa e Treguesve të Shumëfishtë (MICS)

⁵¹ Në vitin akademik 2021/22, 60% të studentëve në nivelin Bachelor në universitete publike dhe private ishin vajza dhe gra. Megjithatë, të rejtat vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuar në fushat STEM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë): vetëm 39% të studentëve të regjistruar në fushën STEM në nivelin Bachelor ishin vajza dhe gra (ASK 2022: Statistikat e Edukimit në Kosovë 2021/22).

⁵² ASK (2022): Anketa e Fuqisë Punëtore 2021

⁵³ Si më lartë.

⁵⁴ Millennium Challenge Corporation (2018). Kosovo Labor Force and Time Use Study Research Report.

2022, vajzat dhe gratë në Kosovë kalojnë 44% më shumë kohë duke kryer punë kujdesi të pa paguar (6.2 orë në ditë) krahasuar me djemtë dhe burrat (3.5 orë në ditë).⁵⁵

Ndonëse përfshirja e fëmijëve dhe të rinjve të komuniteteve **rom, ashkali, dhe egjiptian**⁵⁶ në sistemin edukativo-arsimor në Kosovë ka shënuar përmirësime gjatë dekadës së fundit, ajo ende mbetet e ulët në krahasim me popullatën e përgjithshme. Mesatarisht 84% të fëmijëve romë, ashkalinjë, dhe egjiptianë ndjekin arsimin fillor (kundrejt 100% të popullatës së përgjithshme), 63% ndjekin arsimin e mesëm të ulët (kundrejt 93% të popullatës së përgjithshme), dhe vetëm 31% (kundrejt 87%) ndjekin arsimin e mesëm të lartë.⁵⁷ Rrjedhimisht, të rinjtë e këtyre komuniteteve përballen me shkallën më të lartë të papunësisë në Kosovë dhe në Ballkan.⁵⁸ 78% të të rinjve romë, ashkalinjë, dhe egjiptianë të moshës 18-24 vjeçare nuk janë në punësim, arsim, ose trajnim (NEET), në krahasim me 47% të popullsisë së përgjithshme.⁵⁹ 88% e vajzave dhe grave nga këto komunitete janë në kategorinë NEET, krahasuar me 70% të meshkujve⁶⁰. Supozohet se rreth 4% e femrave nga këto komunitete janë të punësuar, kundrejt 21% të meshkujve.⁶¹ Përballë varfërisë së skajshme dhe privimit material, të rinjtë e këtyre komuniteteve shpesh detyrohen të bëjnë zgjidhje të palakmueshme e deri në një masë edhe të rrezikshme për ta, si braktisja e shkollës, përfshirja në martesë të hershme, angazhimi në punë të rrezikshme, etj. Martesat e hershme⁶² mbeten një problem i përhapur në këto komunitete: Një në tre femra dhe 1 në 10 meshkuj të moshës 20-24 vjeç të komuniteteve rom, ashkali, dhe egjiptian raportuan të jenë martuar para moshës 18 vjeçare.⁶³

Sa i përket fëmijëve dhe të **rinjve me aftësi të kufizuara**⁶⁴, vlerësohet se rreth 38,000 (ose 88%) e tyre nuk janë të regjistruar fare në shkollë⁶⁵. Personat aftësi të kufizuara të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian, kanë dukshëm më pak vite mesatare të arsimit (me 45% që nuk e kanë frekuentuar kurrë shkollën), gjë që vështirëson mundësitë e tyre për punësim cilësor.⁶⁶ Sipas të dhënave të vitit 2019, vetëm 15% të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë ishin të punësuar.⁶⁷ Të rinjtë me aftësi të kufizuara në Kosovë gjithashtu përballen me qasje jo të barabartë dhe jo cilësore në shërbime shëndetësore. Meqenëse sistemi i shëndetësisë publike nuk ofron shërbime të individualizuara rehabilitimi, këto shërbime ofrohen pjesërisht nga organizatat kosovare për personat me aftësi të kufizuara. Megjithatë, duke qenë se shumica prej tyre kanë kapacitete e resurse të limituara, këto organizata nuk arrijnë të mbulojnë nevojat e të gjithë të rinjve me aftësi të kufizuara.

Të rinjtë nga zonat rurale në Kosovë gjithashtu vazhdojnë të përballen pabarazi dhe barriera të ndryshme. Qasja në arsim cilësor për këtë kategori është më e ulët në krahasim me të rinjtë që jetojnë

⁵⁵ Instituti për Politika Sociale "Musine Kokalari" (2022). [Përkujdesi si punë e papaguar në Kosovë](#).

⁵⁶ Sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2011, në Kosovë jetojnë 35,784 persona nga komunitetet rom, ashkali, dhe egjiptian, duke përbërë kështu rreth 2% e popullsisë së përgjithshme.

⁵⁷ ASK & UNICEF 2020: Anketa e Treguesve të Shumëfishtë (MICS).

⁵⁸ Rreth 50% në vitin 2017 (për grupmoshën 15-64 vjeçare) (Banka Botërore, UNDP, BE 2018: [Anketa Rajonale e Romëve 2017](#)).

⁵⁹ Banka Botërore, UNDP, BE 2018: [Anketa Rajonale e Romëve 2017](#)

⁶⁰ Si më lartë.

⁶¹ Si më lartë.

⁶² Martesa e fëmijëve, gjithashtu e referuar si martesë e hershme, është çdo martesë ku të paktën njëra nga palët është nën moshën 18-vjeçare.

⁶³ ASK & UNICEF (2020): Anketa e Treguesve të Shumëfishtë (MICS)

⁶⁴ Gati 100,000 qytetarë në Kosovë – rreth 8% e popullsisë së përgjithshme – jetojnë me ndonjë formë të aftësisë së kufizuar.

⁶⁵ UNMIK Kosovë (2019): [38,000 fëmijë me aftësi të kufizuara nuk e frekuentojnë shkollën](#)

⁶⁶ Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve 2018.

⁶⁷ Save the Children Kosova (2022): [Zërat e Rinj](#)

në zona urbane⁶⁸. Sipas një studimi, 76% të të rinjve të moshës 15-24 vjeçare që jetojnë në zona rurale ishin të papunë.⁶⁹ Për sa i takon papunësisë në baza gjinore, rezultatet tregojnë se femrat që jetojnë në zona rurale janë në disavantazh në tregun e punës në raport me meshkujt, me 80.5% të të rejave rurale të papuna, në krahasim me 67.6% të meshkujve të papunë.⁷⁰

Të rinjve që vijnë nga zonat rurale shpesh u mungojnë mjetet e nevojshme të mobilitetit për të pasur qasje në aktivitetet e pjesëmarrjes për shkak të pozicionit gjeografik dhe sfidave të transportit për të qasur aktivitetet që shpesh operojnë në zona më urbane. Në veçanti, programet e edukimit joformal, hapësirat rinore, sportive dhe kulturore, qendrat rekreative dhe multifunkionale, , aktivitetet e natyrës politike/shoqërore dhe aktivitetet e tjera pjesëmarrëse bazohen në qytete më të mëdha me një mjedis më urban. Ekziston një mungesë e ndërjegjësimit dhe avokimit mbi rëndësinë e pjesëmarrjes aktive mes të rinjve nga të gjitha vendbanimet gjeografike. Me gratë e reja, dhe gjithashtu të rinjtë në përgjithësi, vetëdijësimi i ulët për përfitimet që mund të shfaqen si pasojë e pjesëmarrjes¹⁴pecife, mund të kontribuoj në ngurrimin e tyre për pjesëmarrje.⁷¹

Perceptimet negative dhe gjuha e urrejtjes dhe e intolerancës ndaj të rinjve të komunitetit **LBGTIQ+**⁷² në Kosovë është e lartë. Sipas një ankete të organizuar nga Banka Botërore në vitin 2018, 27% e të anketuarve të komunitetit **LBGTIQ+** (mosha mesatare e të cilëve ishte 27.6 vjeç) raportuan se kanë përjetuar diskriminim në punë dhe 28% kanë përjetuar diskriminim nga personeli i shkollës/universitetit në 12 muajt e fundit. Më tej, 82% deklaruan se vazhdimisht përjetojnë sulme dhe ngacmime të formave të ndryshme dhe 41% raportuan të jenë sulmuar fizikisht/seksualisht ose janë kërcënuar me dhunë.⁷³ Për më tepër, 73% kanë deklaruar se ata nuk ndihen të sigurtë dhe i shmangen vendeve apo hapësirave të ndryshme publike.

Në mënyrë të ngjashme, **marrëdhëniet dhe ndërveprimet ndëretnike** ndërmjet të rinjve të etniciteteve të ndryshme në Kosovë, vecanërisht ndërmjet atyre kosovarë dhe serbë, nuk janë në nivelin e dëshiruar. Vetëm 29% e të rinjve serbë dhe 21% e të rinjve shqiptarë pajtohen se mësimi i gjuhës së përbashkët duhet të jetë i detyrueshëm për të dy komunitetet.⁷⁴ Nga ana tjetër, rreth 40% e të rinjve Kosovarë konsiderojnë se marrëdhëniet ndëretnike janë ende të tensionuara.⁷⁵ Këto gjetje përkojnë edhe me përgjigjet e popullsisë së përgjithshme: 42% të qytetarëve Kosovarë (dhe 73% të qytetarëve në Serbi) nuk e konsiderojnë të mundshme paqen midis Kosovës dhe Serbisë.⁷⁶

Sa i përket **kulturës dhe rekreacionit (apo kohës së lirë)**, të rinjtë Kosovarë nuk shpenzojnë kohë të mjaftueshme në aktivitete të cilat ndikojnë në zhvillimin e tyre personal dhe profesional. Të pyetur mbi aktivitetet që bëjnë më së shpeshti, të rinjtë në Kosovë përqendrojnë kohën e tyre të lirë duke kaluar kohë me familjen (70%), për të vijuar më pas me dëgjimin e muzikës (49%), dhe shikimin e

⁶⁸ Për sa i takon nivelit të arsimimit, 1.7% nga 602 të rinj (15-24 vjeç) të anketuar që jetojnë në zona rurale nuk kanë kurrfarë arsimimi formal, 16% e kanë përfunduar vetëm shkollimin fillor, dhe gati gjysma (47%) ka përfunduar shkollimin e mesëm (OJQ LENS, përkrahur nga Friedrich Ebert Stiftung (2018): [Të Rinjtë Ruralë të Kosovës](#))

⁶⁹ OJQ LENS, përkrahur nga Friedrich Ebert Stiftung (2018): [Të Rinjtë Ruralë të Kosovës](#)

⁷⁰ OJQ LENS, përkrahur nga Friedrich Ebert Stiftung (2018): [Të Rinjtë Ruralë të Kosovës](#)

⁷¹ https://kyp-ks.com/wp-content/uploads/2022/06/Initial-Mapping-Exercise-Report_KYP.pdf

⁷² Persona lezbikë, homoseksualë, biseksualë, transgjinorë, queer dhe interseks

⁷³ Banka Botërore 2018: Jeta në Margjina: Rezultatet e anketës për përvojat e personave LGBTI në Evropën Juglindore).

⁷⁴ Friedrich Ebert Stiftung (2019): Studimi i të rinjve, Kosovë. Më shumë se një e treta e të rinjve shqiptarë dhe pothuajse gjysma e të rinjve serbë janë të bindur se nuk ka nevojë të mësojnë gjuhën tjetër.

⁷⁵ UNKT (2021): Sfidat dhe këndvështrimet e të rinjve në Kosovë

⁷⁶ Banka Botërore (2021): Vlerësimi i rrezikut dhe reziliencës, Kosovë

filmave (31%).⁷⁷ Nga ana tjetër, vetëm 6% të të anketuarve deklaruan se angazhohen në punë vullnetare, 5% në aktivitete të qendrave rinore, 19% në aktivitete të përbashkëta kreative, dhe 28% në aktivitete sportive.⁷⁸ Pjesëmarrja e të rinjve në aktivitete të tilla sigurisht që varet edhe nga ekzistenca dhe kushtet e hapësirave të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, artistike, dhe sportive, informimi apo vetëdijësimi i të rinjve për rëndësinë e pjesëmarrjes, si dhe përballueshmëria financiare e tyre. Më tej, zhvillimi i teknologjive moderne gjithmonë e më shumë po ndikon në rritjen e vazhdueshme të varësisë kibernetike të të rinjve. Të rinjtë në Kosovë shpenzojnë mesatarisht 20.8 orë në javë në internet dhe vetëm 8.7 orë në javë në lexim.⁷⁹ Dy arsyt kryesore për përdorimin e internetit nga të rinjtë janë komunikimi me të afërmit apo miqtë (85%) dhe përdorimi i rrjeteve sociale (83%). Kjo statistikë përkon edhe me sjelljet e të rinjve në BE, 84% e të cilëve e shfrytëzojnë internetin për të kaluar kohë në rrjete sociale.⁸⁰ Ndërkaq vetëm 50% e të rinjve Kosovarë e përdorin internetin për qëllime edukative apo për punë.⁸¹

Duke qenë se efektet e tyre po bëhen gjithnjë e më të dukshme, sfidat lidhur me **mbrojtjen e mjedisit** kanë filluar të zënë një vend të rëndësishëm në diskursin e të rinjve Kosovarë. Rreth 50% e të rinjve në Kosovë e perceptojnë situatën në lidhje me problemet mjedisore si “alarmisht serioze”, pasuar nga 30% të tjerë që e konsiderojnë situatën si “shumë serioze”.⁸² Nga një listë e problemeve më të rëndësishme mjedisore, 66% përzgjedhën ndotjen e ajrit dhe 52% menaxhimin e mbeturinave.⁸³ Ndërkaq, “ndryshimi i klimës” është parë si një çështje e rëndësishme mjedisore vetëm nga 3.2% e të anketuarve.⁸⁴ Sa i përket pjesëmarrjes së të rinjve Kosovarë në aktivitete të ndryshme që synojnë mbrojtjen e mjedisit dhe ndërgjegjësimin e komunitetit të tyre të gjerë mbi këto çështje, rreth 29% të të rinjve të anketuar nga organizata GAIA në vitin 2019 thanë se promovojnë mbrojtjen e mjedisit në baza të rregullta, të ndjekur nga 25% të cilët deklaruan se promovojnë mbrojtjen e mjedisit vetëm nëpërmjet mediave sociale, ndërsa 19% theksuan se nuk janë fare të përfshirë në promovimin e mbrojtjes së mjedisit.⁸⁵

Në lidhje me **vullnetarizmin**, platforma ekzistuese për vullnetarizmin KoVo nuk përdoret në mënyrë aktive nga të gjitha palët e interesit si dhe mekanizmat e kontrollit nuk janë vendosur. Informacioni i mbledhur përmes konsultimeve tregon se një numër i konsiderueshëm i OJQ-ve lokale dhe organizatave të tjera nuk janë në dijeni të platformës dhe/ose në rastet kur ata janë në dijeni, atyre u mungojnë njohuritë se si të regjistrojnë vullnetarët. Përveç kësaj, të rinjve u mungojnë njohuritë për regjistrimin e orarit të punës vullnetare dhe përdorimin e mundshëm të tyre. Përveç kësaj, stimulimet dhe/ose motivimet e ndryshme nuk janë pjesë e sistemit. Për më tepër, mungesa e rregulloreve në nivel komunal se si të angazhohen vullnetarët dhe procesi i punës vullnetare krijon probleme të mëtejshme për të rinjtë. Kjo çon gjithashtu në më pak interesin nga të rinjtë për t'u angazhuar në punë vullnetare pasi ata nuk shohin asnjë përfitim prej saj.

⁷⁷ Si më lartë.

⁷⁸ Si më lartë.

⁷⁹ UNKT (2021): Sfidat dhe këndvështrimet e të rinjve në Kosovë

⁸⁰ Eurostat 2022: [Frekuenca e përdorimit të internetit](#)

⁸¹ Friedrich Ebert Stiftung (2019): Studimi i të rinjve, Kosovë

⁸² GAIA 2019: Perceptimet e rinisë Kosovare për situatën mjedisore në Kosovë

⁸³ Si më lartë.

⁸⁴ Si më lartë.

⁸⁵ Si më lartë.

IV. Vizioni, Objektivi Strategjik, dhe Masat Prioritare

Vizioni, objektivi strategjik, si dhe masat prioritare të kësaj Strategjie pasqyrojnë qëndrimet dhe prioritetet e të rinjve Kosovarë, të identifikuar si pjesë e dialogut të zhvilluar me të rinj në kuadër të fazës së dytë të procesit të hartimit të Strategjisë.⁸⁶ Sipas përgjigjeve të marra nga pyetësi online i zhvilluar me të rinj dhe diskutimeve të drejtpërdrejta, dhjetë sfidat kryesore të të rinjve në Kosovë lidhen me qasjen në arsim cilësor, shëndetin mendor, qasjen dhe cilësinë në punësim, çështjet e sigurisë si liria e shprehjes, ngacmimet seksuale, dhuna në bazë gjinore, dhe siguria publike, si dhe çështjet mbi përfshirjen e grupeve më të cenueshme, si p.sh përfshirja e të rinjve me aftësi të kufizuara.

Përpos rezultateve të pyetësit dhe diskutimeve të drejtpërdrejta, identifikimi apo zgjedhja e sfidave më prioritare të cilat duhet të trajtohen në këtë Strategji është bërë edhe në bazë të shqyrtimit dhe analizimit të hollësishëm të të gjitha Strategjive sektoriale ekzistuese, planeve të veprimit, dhe politikave të ngjashme rinore në nëntë fusha kyçe tematike që janë identifikuar dhe prioritetuar nga vetë të rinjtë: 1) Arsimi, 2) Shëndeti, 3) Punësimi, 4) Siguria, 5) Mbrojtja e Ambientit, 6) Vullnetarizmi, 7) Angazhimi Qytetar, 8) Kultura dhe Rekreacioni, dhe 9) Barazia dhe Gjithpërfshirja.

Më konkretisht, qëllimi i kësaj analize ishte identifikimi i fushave tematike dhe sfidave specifike rinore të cilat trajtohen mirë nga Strategjitë tjera ekzistuese dhe i atyre që nuk trajtohen fare (ose nuk trajtohen në mënyrë efektive). Sipas kësaj analize, është evidentuar se dy nga fushat tematike të cilat trajtohen mirë nga Strategjitë ekzistuese janë ajo e punësimit (trajtuar në mënyrë të hollësishme dhe gjithpërfshirëse në Planin e Zbatimit për Garanci Rinore 2023-2025)⁸⁷ dhe e qasjes në arsim cilësor (trajtuar përmes Strategjisë së Arsimit 2022-2026).

Marrë parasysh këto gjetje, është dakorduar aplikimi i qasjes ombrellë të kësaj Strategjie, e cila nga njëra anë përfshin Strategjitë sektoriale që në mënyrë efektive trajtojnë çështjet me të cilat përballen të rinjtë, dhe nga ana tjetër fokusohet në fusha apo sfida të tjera që nuk trajtohen nga dokumente të tjera strategjike. Për shembull, Strategjitë dhe/apo dokumentet tjera ekzistuese sektoriale (si p.sh. ato në fushën e punësimit dhe qasjes në arsim cilësor) përfshihen në këtë Strategji, por nuk do të përcaktohen intervenime apo masa politike për këto fusha meqenëse veçse ekzistojnë intervenime të planifikuara për to.⁸⁸ Ndërsa temat apo sfidat tjera si shëndeti mendor, siguria, gjithpërfshirja, mbrojtja e ambientit, angazhimi qytetar, të cilat nuk trajtohen (ose nuk trajtohen mirë) nga asnjë dokument tjetër strategjik, trajtohen drejtpërsëdrejti në këtë Strategji, përmes hartimit të masave politike dhe veprimeve specifike në planet e veprimit.

⁸⁶ Përkatesisht faza e identifikimit, konsultimit, dhe zgjedhjes së sfidave që duhet të trajtohen në Strategji.

⁸⁷ Garancia Rinore është një zotim politik i ndërmarrë nga të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së për të siguruar të drejtën e çdo të riu nën 29 vjeç për punësim cilësor, edukim të vazhdueshëm dhe/ose praktikë të të nxënësve ose program stazhi brenda katër muajve goftë nga lënia e arsimit formal ose nga momenti i mbetjes papunë.

⁸⁸ Nëse dokumentet e tilla nuk do të vazhdojnë përtej periudhës aktuale të mbulimit (pra 2024-2032), atëherë masat dhe veprimet konkrete për këto fusha do të zhvillohen dhe do të jenë pjesë e kësaj Strategjie.

Vizioni

Vizioni i SShR-së është që **të gjithë të rinjtë, pa dallim, të realizojnë nevojat dhe të drejtat e tyre në një mënyrë që u mundëson të arrijnë potencialin e tyre të plotë njerëzor dhe të marrin pjesë aktivisht në të gjitha sferat e shoqërisë.**

Objektivat

Vizioni i SShR-së synohet të jetësohet përmes një objektivi strategjik dhe tre objektivave specifike. Objektivi strategjik është që **të rinjtë të gëzojnë një jetë të shëndetshme, të sigurtë, të mirëqenë, dhe kontribuojnë drejt zhvillimit të një shoqërie gjithpërfshirëse dhe të qëndrueshme.** Përmes këtij objektivi strategjik priten të arrihen përmirësime të përgjithshme në fushat kryesore që kanë të bëjnë me rininë, si në arsim, punësim, shëndet, siguri, vullnetarizëm, angazhim qytetar, kulturë dhe rekreacion, mbrojtje të mjedisit, barazia dhe gjithpërfshirje, etj. Thënë ndryshe, objektivi strategjik paraqet një qëllim më të gjerë, afatgjatë, dhe të nivelit më të lartë, i cili orienton drejtimin e përgjithshëm të rinisë Kosovare për periudhën 2024-2032. Disa nga caqet që synohen të arrihen përmes këtij objektivi përfshijnë uljen e shkallës së papunësisë së të rinjve, uljen e numrit të të rinjve të kategorisë NEET, rritjen e cilësisë së arsimit (që matet me rezultatet e testit PISA), përmirësimin e shëndetit mendor dhe riprodhues të të rinjve, uljen e shqetësimeve lidhur me sigurinë e të rinjve (si atë fizike ashtu edhe atë kibernetike), rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje, vullnetarizëm, etj. Ky objektivi strategjik ngërthen në vete parimin e gjithpërfshirjes e qëndrueshmërisë, duke reflektuar qasjen ndërsektoriale të Strategjisë e cila kërkon sinergji, koordinim, dhe bashkëveprim të ngushtë të të gjithë akterëve relevantë dhe vetë të rinjve si partnerë kyç në zhvillim si në nivel kombëtar dhe atë komunal.

Objektivi strategjik pritet të arrihet në bazë të zbatimit të tre dokumenteve strategjike. Përmirësimet lidhur me punësimin e të rinjve priten të arrihen përmes zbatimit të Garancisë Rinore dhe Planit përkatës të Veprimit, ndërsa ato lidhur me arsimin do të realizohen përmes zbatimit të Strategjisë së Arsimit dhe Planit të saj të Veprimit. Nga ana tjetër, fushat tjera të rëndësishme për të rinjtë, që nuk trajtohen apo nuk janë trajtuar në mënyrë adekuate nga dokumente strategjike tjera, si shkathtësitë jetësore, shëndeti mendor, shëndeti seksual dhe riprodhues, siguria, angazhimi dhe pjesëmarrja e të rinjve (përfshirë edhe vullnetarizmin), barazia dhe gjithpërfshirja, etj., do të trajtohen drejtpërdrejt nga kjo Strategji përmes tre objektivave specifike. Treguesit e përcaktuar për objektivin strategjik, në bazë të të cilëve do të bëhet edhe monitorimi dhe vlerësimi i arritjes së këtij objektivi, janë reflektuar në pasaportën e treguesve (Shtojca 2 e këtij dokumenti).

Figura 1. Planet e veprimit për zbatimin e objektivit strategjik dhe objektivave specifike të SShR-së



Përmes tre objektivave specifike, SShR fokusohet në tre fusha të veprimit, të përmbledhura në tre fjalë kryesore: **Fuqizo**, **Shërbe**, dhe **Angazho**. Secili objektivi specifik përfshin në vete masa politike dhe veprime të cilat targetojnë të rinjtë e marginalizuar në Kosovë (si vajzat dhe gratë, të rinjtë me aftësi të kufizuara, të rinjtë e komuniteteve pakicë, të rinjtë nga zonat rurale, të rinjtë që jetojnë në varfëri, etj.). Thënë ndryshe, barazia dhe gjithpërfshirja do të shkrihen në mënyrë të tërthortë në secilin nga tre objektivat specifike të Strategjisë. Duke integruar gjithpërfshirjen dhe barazinë në të tre shtyllat kryesore të saj, Strategjia synon ndërtimin e një shoqërie më të drejtë, të barabartë, dhe të bashkuar. Objektivat specifike të SShR-së shtjellohen në mënyrë më të detajuar në vijim.

Objektivi Specifik 1: Fuqizimi apo pajisja e të rinjve me shkathtësi jetësore thelbësore për një jetë të suksesshme e të mirëqenë. Përmes këtij objektivi synohet pajisja e të rinjve Kosovarë me shkathtësi jetësore, të domosdoshme për zhvillimin personal dhe profesional të tyre dhe fuqizimin e tyre për të jetuar një jetë të mirëqenë e të suksesshme, në harmoni me të tjerët. Shkathtësitë jetësore thelbësore definoohen nga Organizata Botërore e Shëndetësisë si, “një grup kompetencash psikosociale dhe aftësish ndërpersonale që i ndihmojnë njerëzit të marrin vendime të informuara, të zgjidhin problemet, të mendojnë në mënyrë kritike dhe kreative, të komunikojnë në mënyrë efektive, të ndërtojnë marrëdhënie të shëndetshme, të empatizojnë me të tjerët dhe të përballojnë dhe menaxhojnë jetën e tyre në mënyrë të shëndetshme dhe në mënyrë produktive. Shkathtësitë jetësore thelbësore mund të drejtohen drejt veprimeve personale dhe/apo veprimeve ndërpersonale, si dhe drejt veprimeve për të ndryshuar mjedisin përreth për ta bërë atë të favorshëm për shëndetin.”⁸⁹ Masat/ndërhyrjet dhe veprimet specifike të cilat parashihen të zbatohen në kuadër të këtij objektivi mbulojnë fusha të ndryshme të shkathtësive jetësore si i) Edukimi shëndetësor (fizik, seksual dhe mendor) ii) Aftësitë socio-emocionale, iii) Aftësitë dixhitale dhe njohuri kompjuterike, iv) Edukimi qytetar, v) Edukimi mbi sigurinë dhe kohezionin social, vi) Edukimi rreth mbrojtjes së mjedisit, vii)

⁸⁹ “Skills for Health” Skills-based health education including life skills: An important component of a Child-Friendly/Health-Promoting School. <https://iris.who.int/bitstream/handle/10665/42818/924159103X.pdf?isAllowed=y&sequence=1>

Edukimi kulturor, artistik, dhe sportiv etj. Pajisja e të rinjve me shkathtësi jetësore planifikohet të bëhet përmes ndërhyrjeve të ndryshme, si p.sh. përmes edukimit joformal dhe punës rinore (duke përfshirë edhe mbështetje për mobilitetin e të rinjve, përfshirë edhe zbatimin e programit zhvillimor të Shoqatës së Kartës Rinore Evropiane (EYCA)⁹⁰ në Kosovë, dhe angazhimit të drejtpërdrejt të të rinjve të diasporës), edukimit formal (gjegjesisht inkuadrimit më efektiv të këtyre temave në mësimdhënie), zhvillimit dhe promovimit të një Platformeje Rinore si pikë hyrjeje e vetme dixhitale për të rinjtë që ofron informata dhe shërbime të ndryshme për të rinjtë, zhvillimit të programeve të vetë-nxënjes, përmirësimit të koordinimit të programeve financiar nga niveli qendror dhe ai lokal, etj.

Objektivi Specifik 2: Përmirësimi i disponueshmërisë, qasshmërisë, dhe cilësisë së shërbimeve (online dhe të drejtpërdrejta) dhe mbështetjes ofruar të rinjve, që në mënyrë efektive adresojnë nevojat të tyre. Masat politike të parapara nën këtë objektivi do të mbulojnë përmirësimin e cilësisë, efektivitetit, dhe qasshmërisë së shërbimeve lidhur me i) Shëndetin mendor, ii) Shëndetin seksual, iii) Varësinë dhe abuzimet me substancat narkotike dhe iv) Parandalimin apo raportimin e ngacmimeve, bullizmit, dhe dhunës (të formave të ndryshme) etj. Disa prej ndërhyrjeve kryesore të planifikuara përfshijnë ofrimin e shërbimeve cilësore online (p.sh. përmes Platformës online), përmirësimin e shërbimeve të ofruara në mënyrë të drejtpërdrejt (duke përfshirë rritjen e numrit dhe kapaciteteve të profesionistëve dhe/apo ofruesve të shërbimeve, përmirësimin apo krijimin e hapësirave adekuate dhe gjithpërfshirëse për ofrimin e këtyre shërbimeve, etj.), organizimin e hulumtimeve dhe analizave të ndryshme për të kuptuar më mirë mangësitë e shërbimeve dhe zbatimin e rekomandimeve që rrjedhojnë nga to, përfshirja e të rinjve në planifikimin, zhvillimin, dhe vlerësimin e shërbimeve të ofruara, etj.

Objektivi Specifik 3: Përmirësimi i politikave rinore dhe fuqizimi i të rinjve në vendimarrje, politikëbërje, dhe zbatim të programeve që synojnë zhvillimin e shoqërisë. Ky objektivi parasheh zbatimin e masave të ndryshme politike me qëllim të përmirësimit të politikave rinore që në mënyrë më efektive dhe efikase të mbështesin zhvillimin dhe fuqizimin e të rinjve si në aspekt personal por edhe si agjentë të ndryshimit pozitiv në komunitet dhe shoqëri. Disa prej ndërhyrjeve të parapara nën këtë objektivi përfshijnë: ri-organizimin dhe fuqizimin e strukturave rinore (këshillave rinor, këshillave të nxënësve, parlamenteve studentore universitare, etj.), organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë, krijimin dhe funksionalizimin e hapësirave rinore (gjegjesisht të qendrave rinore) sipas standardeve cilësore e gjithpërfshirëse, funksionalizimin dhe fuqizimin e Agjencisë për Zhvillimin e Rinisë (në linjë me Projektligjin për Rininë), promovimin dhe rritjen e cilësisë së vullnetarizmit, angazhimit e të rinjve në dialogje të rregullta dhe të strukturuar me politikëbërës, përfundimin apo krijimin e mekanizmave që nxisin pjesëmarrjen e të rinjve në vendimarrje, politikëbërje, dhe zhvillim të komunitetit të tyre dhe ngritja e kapaciteteve të institucioneve dhe të rinjve për aplikimin e modeleve për pjesëmarrjen e të rinjve në këto procese, rishikimin e kornizës ligjore dhe politikave bazuar në prova duke krijuar e një sistemi efektiv dhe të qëndrueshëm për mbledhjen, përpunimin, dhe raportimin e rregullt të të dhënave për të rinjtë, etj.

⁹⁰ [Shoqata e Kartës Rinore Evropiane \(EYCA\)](#) është themeluar në vitin 1987 me qendër në Bruksel, Belgjikë. Ajo është një organizatë jo fitimprurëse që përfaqëson një rrjet prej 41 organizatave degë të saj në 36 vende të Evropës, me mbi 7 milionë të rinj kartëmbajtës. Organizata anëtare administron kartën rinore dhe i ofron të rinjve përfitime në fushat e lëvizshmërisë, akomodimit, kulturës si dhe zbritje të vlerës në shërbime dhe produkte. EYCA gjithashtu vepron në partneritet me Komisionin Evropian, Këshillin e Evropës, Euro Desk dhe European Youth Forum.

V. Mekanizmat e Zbatimit, Monitorimit dhe Vlerësimit

Mekanizmat e Zbatimit dhe Koordinimit

Zbatimi i SSHR-së do të bëhet sipas tre planeve të veprimit që do të miratohen nga Qeveria. Plani i parë i veprimit do të mbulojë periudhën 2024-2026, i dyti periudhën 2027-2029, dhe i fundit periudhën 2030-2032. Si pjesë e kësaj Strategjie (si plane shtesë të veprimit) do të konsiderohen edhe Plani i Veprimit për zbatimin e Garancisë Rinore dhe pjesët relevante të Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë së Arsimit (më gjegjësisht objektivi specifik 2 i këtij plani që trajton ngritjen e cilësisë së arsimit). Nëse planet e tilla shtesë nuk do të vazhdojnë përtej periudhës aktuale të mbulimit (pra 2024-2032), atëherë do të zhvillohen masa dhe veprime konkrete për fushat e trajtuara nga ato dokumente, të cilat do të jenë pjesë e drejtpërdrejt e kësaj Strategjie. Të gjitha institucionet e përfshira në planet e veprimit do të jenë përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë. Këtu përfshihen edhe institucionet që janë pjesë e planeve të veprimit apo Strategjive tjera ekzistuese që adresojnë sfidat specifike me të cilat përballen të rinjtë, si Plani i Zbatimit për Garanci Rinore 2023-2025, Plani i Veprimit i Strategjisë së Arsimit (2022-2026), Draft-Strategjia për Drejtësi Tranzicionale⁹¹ dhe Strategjia për Migrim 2021-2025. Këto institucione do të kenë takime koordinuese çdo tre muaj në nivel teknik si pjesë e grupit të punës, si dhe në nivel vendimmarrës si pjesë e Komisionit Shtetëror për Rini (KShR). Niveli komunal luan një rol të veçantë në mundësimin e zbatimit të Strategjisë ku në Aneksin 3 elaborohet bashkëpunimi i nevojshëm mes nivelit qendror dhe atij lokal. Varësisht nga kosto e aktiviteteve dhe buxhetit të institucioneve përgjegjëse, udhëheqëse dhe/apo mbështetëse, burimet e financimit për zbatim alokohen sipas legjislacionit në fuqi për ndarjet buxhetore me planifikim vjetor dhe afatmesëm dhe plotësohen me mbështetjen e komunitetit të donatorëve në Kosovë.

Monitorimi dhe Vlerësimi

Monitorimi i zbatimit të Strategjisë është një proces i vazhdueshëm i mbledhjes dhe analizimit të informacionit në lidhje me zbatimin e ndërhyrjeve/masave si dhe veprimeve apo aktiviteteve specifike. Monitorimi i zbatimit gjurmon veprimet e zbatuara, burimet financiare të alokuara dhe të shpenzuara në baza të rregullta dhe i krahason ato me planin e veprimit për të vlerësuar efektivitetin dhe efikasitetin e zbatimit të Strategjia. Ndërsa monitorimi i performancës vëzhgon rezultatet e arritura në nivele të ndryshme: (i) masat prioritare, (ii) objektivat specifike dhe (iii) objektivat strategjike. Monitorimi i zbatimit të veprimeve brenda masave prioritare, si dhe monitorimi i burimeve financiare të alokuara dhe të shpenzuara do të bëhet në bazë të planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë. Nga ana tjetër, monitorimi i performancës ose monitorimi i rezultateve do të bëhet në bazë të pasaportës së treguesve (Shtojca 2 e këtij dokumenti) si dhe në bazë të planit të veprimit (Shtoja 1 e këtij dokumenti), ku janë caktuar treguesit e performancës për masat prioritare, objektivat specifike, dhe qëllimet strategjike.

Monitorimi i zbatimit të masave prioritare, veprimeve, dhe burimeve financiare të alokuara dhe të shpenzuara do të kryhet çdo gjashtë muaj, ndërsa monitorimi i performancës do të kryhet në baza vjetore. Ministria e Kulturës, Rinisë, dhe Sportit (MKRS) do të jetë përgjegjëse për mbledhjen dhe

⁹¹ Aplikohet me miratimin e Draft Strategjisë për Drejtësi Tranzicionale nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

sistemimin e informatave të monitorimit nga institucionet përkatëse dhe draftimin e raportit përkatës të monitorimit (gjysmë vjetor dhe vjetor), i cili do t'i dorëzohet KShR-së⁹² për shqyrtim dhe poashtu do të publikohet dhe do të diskutohet edhe me akterë të tjerë relevantë. Raporti gjashtëmujor, i cili përgatitet në fund të muajit pas periudhës raportuese, përgatitet për ndjekjen e zbatimit të planit të veprimit. Ky raport fokusohet në përfundimin e veprimeve të përcaktuara në planin e veprimit, arsyet e vonesave, rreziqet që lidhen me zbatimin e veprimeve, dhe hapat e ardhshëm. Ndërsa raporti vjetor përgatitet në fund të tremujorit të parë të vitit pasardhës. Përpos përfundimit në kohë të veprimeve të përcaktuara në planin e veprimit dhe përdorimi i burimeve financiare, fokusi i raportit vjetor është që të shikohet dhe të analizohet arritja e rezultateve dhe caqeve të masave prioritare si dhe objektivave specifike duke i krahasuar ato me caqet e treguesit e definuar në kornizën e monitorimit dhe vlerësimit, si dhe të analizohen pengesat e mundshme dhe masat alternative që mund të adresojnë këto pengesa kryesore gjatë zbatimit të Strategjisë. Këto raporte do t'i paraqiten më pas Komisionit Shtetëror për Rininë për shqyrtim, miratim dhe udhëzime të mëtejshme.

Në kuadër të vlerësimit të Strategjisë do të kryhen dy ushtrime vlerësimi: njëri para përfundimit të fazës së dytë të Strategjisë (2027-2029) dhe njëri në përfundim të Strategjisë (2030-2032). Ushtrimi i parë i vlerësimit (vlerësimi i ndërmjetëm) do të analizojë zbatimin e masave prioritare si dhe rezultatet e arritura. Duke bërë krahasimin me situatën bazë, vlerësimi i ndërmjetëm do të nxjerrë në pah ndryshimet në kontekstin e përgjithshëm dhe do të gjykojë nëse objektivat, masat prioritare, dhe veprimet kyçe mbeten të rëndësishme, përpara fillimit të fazës së tretë të zbatimit të Strategjisë për periudhën 2030-2032. Ky vlerësim do të shqyrtojë gjithashtu nëse ka ende një koherencë të plotë midis objektivave të Strategjisë dhe prioriteteve dhe politikave kombëtare. Vlerësimi i ndërmjetëm do të mbështetet në informacionin e nxjerrë nga sistemi i monitorimit dhe nga konteksti i përgjithshëm dhe do të ofrojë udhëzime për rishikimin e planit të veprimit të Strategjisë. Vlerësimi përfundimtar, që do të kryhet në vitet 2031-2032, do të analizojë gjithë ecurinë e Strategjisë në tërësi. Ky vlerësim do të raportojë mbi efektivitetin, rëndësinë dhe relevancën, efikasitetin, gjithpërfshirjen, dhe qëndrueshmërinë e masave prioritare të Strategjisë.

⁹² Komisioni Shtetëror për Rini u themelua më 11 Gusht 2021 nga Qeveria e Republikës së Kosovës, si mekanizmin më të lartë bashkërendues ndërinstitucional mbi zbatimin e politikave rinore sektoriale dhe ndërsektoriale. Komisioni është pjesë kyçe e procesit të hartimit dhe zbatimit të Strategjisë Shtetërore për Rininë. Siç parashihet edhe në Ligjin e ri për Rininë, roli i KSHR-së në kuadër të kësaj strategjise është monitorimi i zbatimit dhe miratimi i raportit vjetor të strategjisë.

Shtojca 1: Plani i Veprimit (2024-2026)

Draft Plani i Veprimit (2024-2026)

I. Objektivi strategjik 1: Të rinjtë gëzojnë një jetë të shëndetshme, të sigurtë, të begatë, dhe kontribuojnë drejt zhvillimit të një shoqërie gjithpërfshirëse dhe të qëndrueshme					
I.1 Objektivi specifik 1: Fuqizimi i të rinjve me shkathtësi jetësore thelbësore për një jetë të suksesshme e të mirëqenë ⁹³					
N r.	Treguesi	Vlera bazë	2024	2025	2026
1	Numri i të rinjve (të ndarë sipas gjinisë) që janë fuqizuar me shkathtësi jetësore përmes edukimit joformal dhe punës rinore	7,600 (2022)	15,000	20,000	25,000
2	Numri i të rinjve (të ndarë sipas gjinisë) që janë fuqizuar me shkathtësi jetësore përmes edukimit formal	I padisponueshëm	18,000	23,000	28,000
3	Numri i të rinjve (të ndarë sipas gjinisë) që janë fuqizuar me shkathtësi jetësore përmes platformës online	0	0	10,000	50,000
4	Niveli i kënaqshm	I padisponueshëm	I padisponueshëm	70% të kënaqur dhe shumë të kënaqur	70% të kënaqur dhe shumë të kënaqur

⁹³

Masat/ndërhyrjet dhe veprimet specifike të cilat parashihen të zbatohen në kuadër të këtij objekti mbulojnë fusha të ndryshme të shkathtësive jetësore si i) Edukimi shëndetësor (fizik, seksual dhe mendor) ii) Aftësitë socio-emocionale, iii) Aftësitë dixhitale dhe njohuri kompjuterike, iv) Edukimi qytetar, v) Edukimi mbi sigurinë dhe kohezionin social, vi) Edukimi rreth mbrojtjes së mjedisit, vii) Edukimi kulturor, artistik, dhe sportive, etj.

	ërise së përfituesve (të ndarë sipas gjinisë)				
5	Përqindja e të rinjve nga komunitetet tjera që janë fuqizuar me shkathtësi jetësore përmes (i) edukimit joformal & punës rinore, (ii) edukimit formal dhe (iii) platformës online	I padisponueshëm	10%	15%	20%
6	Përqindja e të rinjve me aftësi të kufizuara që janë fuqizuar me shkathtësi jetësore përmes (i) edukimit joformal & punës rinore, (ii) edukimit formal dhe (iii) platformës online	I padisponueshëm	10%	15%	20%
7	Përqindja e të rinjve nga zonat rurale që janë fuqizuar me shkathtësi jetësore përmes (i) edukimit joformal & punës rinore, (ii) edukimit formal dhe (iii)	I padisponueshëm	20%	30%	40%

N r.	Masa	Veprimi ⁹⁴	Afatet	Buxheti			Burim i financimit	Institucioni/et udhëheqës/e	Institucioni/et mbështetës/e	Produkti			
				Viti N1	Viti N2	Viti N3				Treguesit e masës	Vlerat		
											2024	2025	2026
1.1.1	Pajisja e të rinjve me shkathtësi jetësore përmes edukimit joformal cilësor dhe punës rinore cilësore	Hartëzimi i programeve të edukimit joformal me fokus të rinjtë në fushat prioritare që do të adresohen gjatë 2024-2026 (shëndeti mendor, shëndeti riprodhues dhe seksual, siguria, varësia nga substancat narkotike, kultura dhe sporti, marrëdhëniet ndëretnike, mjedisi, etj.)	2024-2025	2,000 (MKR S)	2,000 (MKR S)	/	Buxheti i Kosovës (MKR S / DR)	MKRS	MASHT	Përqindja e programeve që zbatojnë standardet e caktuara	0%	20%	50%
		Përcaktimi i standardeve të cilësisë së programeve të edukimit joformal dhe të punës rinore, të financuara nga Strategjia	2024	2,000 (MKR S)	/	/	Buxheti i Kosovës (MKR S / DR)	MKRS	MASHT	Lloji i shkathtësive jetësore i trajtuar përmes edukimit joformal dhe punës rinore	TD në vitin 2024	TD në vitin 2024	TD në vitin 2024
		Përfshirja e këtyre standardeve në thirrje publike për të gjitha organizatat që ofrojnë edukim joformal	2024	2,000 (MKR S)	/	/	Buxheti i Kosovës (MKR S / DR)	Të gjitha	/				
		Organizimi i thirrjeve publike për ngritjen e shkathtësive jetësore të të rinjve për fushat prioritare të identifikuar	2026	120,000 (MKR S) 200,000 (MAS HT) 20,000 (MSH) 3,000 (ME)	120,000 (MKR S) 200,000 (MAS HT) 30,000 (MSH) 3,000 (ME)	120,000 (MKR S) 200,000 (MAS HT) 40,000 (MSH) 3,000 (ME)	Buxheti i Kosovës (Mbështetja e OJQ-ve që mbështesin qendrat mësimore/komunitet RAE)	Të gjitha	/				

						(MASHT) (MKRS/DR) (MSH) (ME)							
		Digjitalizimi i procesit të aplikimit dhe shqyrtimit të aplikimeve në thirrje publike (për individë dhe organizata joqeveritare)	2025	50,000 (MKRS)	/	/	Buxheti i Kosovës (MKRS / Departamenti i Administratës Qëndrore)	MKRS	OSCE				
		Ofrimi i aktiviteteve edukuese përmes edukatorëve bashkëmoshatarë në fushat prioritare	2024-2026	30,000 (MKRS)	30,000 (MKRS)	30,000 (MKRS)	Buxheti i Kosovës (MKRS/DR)	MASHT	UNICEF, UNFPA				
		Pilotimi dhe zgjerimi i programeve 'Arti dhe Sporti në shkollë'	2024-2026	300,000 (DS) 500,000 (DK)	300,000 (DS) 600,000 (DK)	300,000 (DS) 700,000 (DK)	Buxheti i Kosovës (MKRS/DS/DK)	MKRS	MASHT	Numri i nxënësve të përfshirë në aktivitete fizike të organizuara jashtëkurrikulare në kuadër të institucioneve arsimore (PKZH)	95,000	190,000	20,000
		Organizimi i kampeve rinore në fushat prioritare të identifikuara	2024-2026	50,000 (MKRS) 50,000 (MSH) 50,000 (MPJD) 50,000 (MAPL) 50,000 (MPB)	50,000 (MKRS) 65,000 (MSH) 50,000 (MPJD) 50,000 (MAPL) 50,000 (MPB)	50,000 (MKRS) 80,000 (MSH) 50,000 (MPJD) 50,000 (MAPL) 50,000 (MPB)	Buxheti i Kosovës (MKRS/DR) (MSH) (MPJD) (MAPL) (MPB)	MKRS, MSH, MPJD, MAPL, MPB	/				

	Mbështetja e organizatave sportive me qëllim të promovimit dhe zhvillimit të aktiviteteve fizik rekreacionale dhe shëndetësore (PKZH)	2024-2026	100,000 (MKRS)	100,000 (MKRS)	100,000 (MKRS)	Buxheti i Kosovës (MKRS/DS)	MKRS	/				
	Organizimi i programeve për të nxitur ndërveprimin mes të rinjve të Kosovës dhe diasporës	2024-2026	80,000 (MPJD) 10,000 (MKRS)	80,000 (MPJD) 10,000 (MKRS)	80,000 (MPJD) 10,000 (MKRS)	Buxheti i Kosovës (MPJD) (MKRS)	MPJD	MKRS, MPB				
	Organizimi i programeve që mbështesin mobilitetin e të rinjve brenda dhe jashtë Kosovës (që të rinjtë ta përfaqësojnë Kosovën ndërkombëtarisht)	2024-2026	30,000-50,000 (MASHT) 50,000 (MKRS)	30,000-50,000 (MASHT) 50,000 (MKRS)	30,000-50,000 (MASHT) 50,000 (MKRS)	Buxheti i Kosovës Grantet e mobilitetit (MASHTI) Thirrja e mobilitetit (MKRS)	MPJD dhe MKRS	MASHT				
	Themelimi i Zyres së Kartës Rinore Evropiane (EYCA) në MKRS	2024-2026	10,000 (MKRS)	10,000 (MKRS)	10,000 (MKRS)	Buxheti i Kosovës (MKRS/DR)	MKRS	MPJD, MINT				
	Krijimi i marrëveshjeve me organizata të shoqërisë civile dhe palë të tjera të angazhuara në aktivitete të Kartës Rinore për shpërndarjen e kartave rinore	2024-2026	50,000 (MKRS)	50,000 (MKRS)	50,000 (MKRS)	Buxheti i Kosovës (MKRS/DR)	MKRS	MPJD, MINT				
	Mbështetja e të rinjve për regjistrim në Shoqatën Evropiane të Kartës Rinore dhe pjesëmarrje në programet e shkëmbimit kulturor, programet edukative (p.sh. Erasmus), praktika pune (internships) në vende evropiane, si dhe aktivitete tjera të ndërlidhura me	2024-2026	10,000 (MKRS)	10,000 (MKRS)	10,000 (MKRS)	Buxheti i Kosovës (MKRS/DR)	MKRS	MPJD, MINT				

		Kartën Rinore Evropiane											
		Organizimi i pyetësorit për mbledhjen e përshtypjeve të rinjve për përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga Karta Rinore Evropiane dhe realizimi i përmirësimeve të nevojshme	2024 - 2026	5 000 (MKRS)	5 000 (MKRS)	5 000 (MKRS)	Buxheti i Kosovës (MKRS/DR)	MKRS	MPJD, MINT				
		Ngritja e kapaciteteve të punëtorëve rinorë	2024-2026	30,000 (MKRS)	30,000 (MKRS)	30,000 (MKRS)	Buxheti i Kosovës (MKRS/DR)	MKRS	MASHT				
		Hartimi i një sistemi për regjistrimin, monitorimin, dhe raportimin e përfituesve të thirrjeve publike	2024	10,000 (MKRS)	/	/	Buxheti i Kosovës (MKRS/DR)	MKRS					
		Zbatimi i Planit të Veprimit të Strategjisë për Drejtësi Tranzicionale ⁹⁵ , me qëllim të përmirësimit të marrëdhënieve dhe ndërveprimeve ndëretnike ndërmjet të rinjve të komuniteteve të ndryshme të Kosovës	2024-2026	30,000 (MKRS)	30,000 (MKRS)	30,000 (MKRS)	Buxheti i Kosovës (MD) (MKRS/DR)	MD	MKRS				
1. 1. 2.	Pajisja e të rinjve me shkathtësi jetësore përmes edukimit formal	Zhvillimi i analizës për të përcaktuar mënyrën më të mirë të inkuadrimit apo përforcimit të ligjerimit të këtyre temave (p.sh. edukimi socio-emocional, edukimi seksual dhe riprodhues etj.) në arsimin formal		5,000 (MASHT)	/	/	Buxheti i Kosovës (MASHT)	MASHT	MKRS	Numri i temave të ligjeruara rregullisht dhe sistematikisht & SDG 4.7.1 (Shkallë në të cilën (i) edukimi për qytetarinë globale dhe (ii) edukimi për zhvillim	TD në vitin 2024	TD në vitin 2024	TD në vitin 2024

⁹⁵ Me supozimin se Strategjia për Drejtësi Tranzicionale do të miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

										të qëndrueshëm, duke përfshirë barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut, përfshihe në të gjitha nivelet në: (a) politikat kombëtare të arsimit; (b) kurrikula; (c) edukimi i mësuesve; dhe (d) vlerësimi i nxënësve)			
		Zhvillimi i manualeve për mësimdhënës për përforcimin e ligjerimit të temave të caktuara dhe zbatimi i manualeve ekzistuese	2024	2,500 (MASHT)	/	/	Buxheti i Kosovës (MASHT)	MASHT	Komunat (MAPL), UNICEF (UPP)				
		Trajnimi i mësimdhënësve për integrim të shkathtësive për jetë në mësimdhënie	2026	2,000 (MASHT)	2,000 (MASHT)	2,000 (MASHT)	Buxheti i Kosovës (MASHT) / Donatorët	MASHT	Komunat (MAPL), UNICEF (UPP)				
		Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të manualeve nga mësimdhënësit		10,000 (MASHT)	10,000 (MASHT)	10,000 (MASHT)	Buxheti i Kosovës (MASHT)	MASHT	Komunat (MAPL)				
1.1.3.	Zhvillimi dhe promovimi i Platformës Rinore, si një pikë hyrjeje e vetme dixhitale për të rinjtë	Zhvillimi i platformës së qëndrueshme, e cila është miqësore për të rinjtë dhe e qasshme në pajisje të ndryshme (si desktop, celular, tablet)	2024-2026	25,000 (MKRS)	10,000 Mirëmbajtja dhe ngritja e kapaciteteve (MKRS)	10,000 Mirëmbajtja dhe ngritja e kapaciteteve (MKRS)	Buxheti i Kosovës (MKRS/DR)	MKRS	Të gjitha, (OSCE)	Numri i përdoruesve të platformës	0	20,000	10,000

	(one-stop shop), e cila ofron informata dhe shërbime të ndryshme për të rinjtë	Identifikimi dhe integrimi i të gjitha programeve apo shërbimeve ekzistuese për të rinj në platformë	2024-2026	/	/	/	/	MKRS	Të gjitha				
		Zhvillimi i kontentit të ri të platformës, përfshirë zhvillimin e artikujve, podcasts, infografikave, video-animacioneve, trajnimeve, kurseve online, etj.	2024-2026	20,000 (MKRS)	20,000 (MKRS)	20,000 (MKRS)	Buxheti i Kosovës (MKRS/DR)	Të gjitha	OSCE				
		Promovimi i platformës tek të rinjtë	2024-2026	10,000 (MKRS)	10,000 (MKRS)	10,000 (MKRS)	Buxheti i Kosovës (MKRS/DR)	MKRS	Të gjitha				
		Zhvillimi i programeve të vetënxënjes (self-learning), si p.sh. krijimi i kurseve/trajnimeve të ndryshme online, të integruara në platformën rinore	2024-2026	20,000 (MKRS)	20,000 (MKRS)	20,000 (MKRS)	Buxheti i Kosovës (MKRS/DR)	MKRS	Të gjitha				
I. 1. 4.	Pajisja e të rinjve me shkathtësi jetësore përmes aktiviteteve të vetëdijësuese	Organizimi i fushatave dhe projekteve të ndryshme vetëdijësuese për, me dhe nga të rinjtë, lidhur me dukuritë negative që prekin të rinjtë, si përdorimi i substancave narkotike, dhuna dhe ngacmimet, dhe delikuenca e të miturve	2024-2026	3,000 (MASHT) 5,000 (MKRS) 10,000 (MSH)	3,000 (MASHT) 5,000 (MKRS) 25,000 (MSH)	3,000 (MASHT) 5,000 (MKRS) 40,000 (MSH)	Buxheti i Kosovës (MKRS/DR), (MASHT), (MSH), Donatorët	MASHT, MSH, MPB, MKRS, MD	Të gjitha	Numri i të rinjve që janë përfshirë në këto aktivitete	TD në vitin 2024	TD në vitin 2024	TD në vitin 2024
		Shënimi i Muajit të Rinisë	2024-2026	30,000 (MKRS)	30,000 (MKRS)	30,000 (MKRS)	Buxheti i Kosovës (MKRS/DR)	MKRS	Të gjitha				
		Organizimi i aktiviteteve të vetëdijësuese (si p.sh. trajnimeve joformale të vetëdijësuese) në fushën e sigurisë (nga FSK)	2024-2026	50,000 (MM dhe MPB)	50,000 (MM dhe MPB)	50,000 (MM dhe MPB)	Buxheti i Kosovës (MM dhe MPB)	MM MPB	MPB, MASHT MKRS				
I. 1. 5.	Përmirësimi i koordinimit të programeve	Përcaktimi i mekanizmeve për komunikim dhe shkëmbim të informatave/njohurive/praktikave të mira	2024-2026	5,000 (MAPL)	5,000 (MAPL)	5,000 (MAPL)	Buxheti i Kosovës (MAPL)	MAPL	MKRS	Mekanizmi i krijuar dhe funksional	Jo	Po	Po

financuar nga niveli qendror dhe ai lokal	rreth programeve të edukimit joformal dhe punës rinore në mes të nivelit qendror dhe lokal											
	Koordinim më i mirë i ofrimit të mbështetjes (përmes thirrjeve publike) të programeve të edukimit joformal dhe punës rinore ndërmjet nivelit qendror dhe lokal	2024-2026	5,000 (MAPL)	5,000 (MAPL)	5,000 (MAPL)	Buxheti i Kosovës (MAPL)	MAPL	MKRS	Niveli i koordinimit të programeve			
	Krijimi i një databaze për regjistrimin dhe raportimin sistematik të programeve të zhvilluara dhe përfituesve	2024-2026	10,000 (MAPL)	10,000 (MAPL)	10,000 (MAPL)	Buxheti i Kosovës (MAPL)	MAPL	MKRS				
Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Specifik 1:			2,156,500.00	2,210,000.00	2,348,000.00							
<i>Nga të cilat kapitale:</i>												
<i>Nga të cilat rrjedhëse:</i>												
1. 2	Objektivi specifik 2: Përmirësimi i disponueshmërisë, qasshmërisë, dhe cilësisë së shërbimeve dhe mbështetjes ofruar të rinjve, që në mënyrë efektive adresojnë nevojat të tyre⁹⁶											
N r.	Treguesi	Vlera bazë	2024			2025			2026			
1	Numri i të rinjve (të ndarë sipas gjinisë) që kanë marrë shërbime online	0	0			1,000			2,000			
2	Numri i të rinjve (të ndarë sipas gjinisë) që kanë marrë shërbime të drejtpërdrejta	0	0			500			1,000			
3	Përqindja e të rinjve të komuniteteve tjera që kanë marrë shërbime online dhe të drejtpërdrejta	I padisponueshëm	10%			15%			20%			

⁹⁶ Masat e parapara nën këtë objektivi do të mbulojnë përmirësimin e cilësisë, efektivitetit, dhe qasshmërisë së shërbimeve lidhur me i) Shëndetin mendor, ii) Shëndetin seksual, iii) Varësinë dhe abuzimet me substancat narkotike dhe iv) Parandalimin apo raportimin e ngacmimeve, bullizmit, dhe dhunës (të formave të ndryshme) etj.

4	Përqindja e të rinjve me aftësi të kufizuara që kanë marrë shërbime online dhe të drejtpërdrejta	I padisponueshëm	5%	7%	10%									
5	Përqindja e të rinjve nga zonat rurale që kanë marrë shërbime online dhe të drejtpërdrejta	I padisponueshëm	20%	30%	40%									
6	Kënaqshmëria e të rinjve me shërbimet e marra online dhe drejtpërdrejtë	I padisponueshëm	I padisponueshëm	70% të kënaqur dhe shumë të kënaqur	70% të kënaqur dhe shumë të kënaqur									
N r.	Masa	Veprimi ⁹⁷	Afatet	Buxheti			Burimi i financimit	Institucioni/et udhëheqës/e	Institucioni/et mbështetës/e	Produkti	Vlerat			
				Viti N1	Viti N2	Viti N3					Treguesit e masave	202	20	20
												4	25	26
1.2.1	Përmirësimi i shërbimeve të ofruara në mënyrë të drejtpërdrejtë apo fizike	Organizimi i hulumtimit për të kuptuar më mirë shërbimet e ofruara dhe për të identifikuar nevojat për përmirësimin e tyre	2025	/	10,000 (MSH)	/	Buxheti i Kosovës (MSH)	MSH	MKRS	Përqindja e shkollave dhe QKMF-ve që kanë psikolog	TD në vitin 2024	TD në vitin 2024	TD në vitin 2024	
		Ndryshimi i UA-së për kujdesin parësor shëndetësor (MSH) të nevojshëm për vendosjen e psikologëve në QKMF	2024	3,000 (MSH)	/	/	Buxheti i Kosovës (MSH)	MSH	MASHT, Komunitat (MAPL)	Numri i shërbimeve/objektiveve me karakteristika të përmirësuar ndaj të rinjve	TD në vitin 2024	TD në vitin 2024	TD në vitin 2024	
